



Vjetari Statistikor Rajonal 2015

VJETARI STATISTIKOR RAJONAL

2015

VJETARI STATISTIKOR RAJONAL, 2015

Drejt看 botimi: **Dr. Gjergji FILIPI**

Përpunimi Statistikor: **INSTAT**

© *Copyright INSTAT 2015*

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë,
pa autorizimin paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

Përpunimi në kompjuter: **Teuta Topi**
Anila Koçi

INSTITUTI I STATISTIKAVE
Bul. "Zhan D'Ark", Nr.3, Tiranë / Albania
Tel: + 355 4 2222411 / 2233356
Fax: + 355 4 228300
e-mail: info@instat.gov.al
www.instat.gov.al

PËRMBAJTJE

1. POPULLSIA	9
Tab.1 Popullsia mesatare sipas gjinisë dhe qarqeve, 2010-2014	10
Tab.2 Dendësia e popullsisë, 2014	11
Fig. 1 Dendësia e popullsisë, 2014	12
Tab.3 Popullsia mesatare sipas grupmoshës dhe gjinisë, qarqe 2014	13
Fig. 2 Struktura e popullsisë së qarqeve, sipas tre grupmoshave të mëdha, 2014	13
Tab.4 Raportet e varësisë, 2014	14
Fig. 3 Koeficienti i ndryshimit të popullsisë dhe i shtesës natyrore, mesatare 2010-2014	15
Fig. 4 Norma bruto e ndryshimit të popullsisë, 2010-2014	16
Fig. 5 Lëvizjet e brendshme të popullsisë, 2014	17
Fig. 6 Norma bruto e migracionit neto të brendshëm, 2014	17
Fig. 7 Norma bruto e lindjeve, 2014	18
Fig. 8 Indeksi sintetik i fekonditetit, 2014	19
Fig. 9 Mosha mesatare e vdekjeve sipas qarqeve dhe mosha mesatare e vdekjeve në gjithsej, 2014	20
Fig. 10 Norma bruto e vdekjeve, 2014	21
Fig. 11 Numri i martesave gjithsej, 2010-2014	22
Fig. 12 Norma bruto e martesave sipas qarqeve, 2014	22
Tab. 5 Popullsia mesatare sipas qarqeve dhe zonave urbane dhe rurale, 2010-2014	24
2. PROJEKSIONET	25
Tab.1 Projektionet e popullsisë sipas gjinisë 2011 - 2031	25
Fig. 1 Norma e rritjes së popullsisë, 2011 - 2031	26
Fig. 2 Raporti gjinor 2011	27
Fig. 3 Raporti gjinor 2031	28
3. STATISTIKAT JURIDIKE	29
Tab.1 Veprat penale, 2010-2014	29
Fig. 1 Dhuna në familje, 2010-2014	30
Tab. 2 Të burgosurit sipas dy ndarjeve të mëdha moshore dhe qarqeve, 2010-2014	31
Fig. 2 Norma e të burgosurve për 10.000 banorë, 2014	31
Fig. 3 Norma e ndryshimit në numër e të burgosurve, 2010-2014	32
4. SHËNDETËSIA	34
Fig. 1 Numri i Poliklinikave, 2013	34
Fig. 2 Qendrat Shëndetësore, 2013	35
Fig. 3 Numri i Spitaleve, 2013	36
Fig. 4 Shtretër për 10.000 banorë, 2013	37
Tab.1 Numri i Poliklinikave, 2009-2013	38

Tab. 2 Qendra shëndetësore, 2009-2013	38
Tab. 3 Ambulanca, 2009-2013	39
Tab. 4 Konsultori i fëmijëve, 2009-2013	39
Tab. 4.1 Konsultori i gruas, 2009-2013	40
Tab. 5 Aktiviteti i spitaleve, 2009-2013	40
Tab. 6 Aktiviteti i spitaleve, 2009-2013	41

5. ARSIMI42

Fig. 1 Nxënës për një mësues në ciklin e lartë të 9 vjeçares, në arsimin publik dhe privat, 2013 - 2014	42
Fig. 2 Nxënës për një mësues në arsimin e mesëm publik dhe privat, 2013-2014	43
Tab. 1 Shkolla 9 vjeçare	44
Tab. 2 Mësues në shkollat 9 vjeçare	44
Tab. 3 Nxënës të regjistruar në arsimin 9 vjeçar	45
Tab. 4 Nxënës të regjistruar në arsimin 9 vjeçar, cikli i ulët	45
Tab. 5 Nxënës të regjistruar në arsimin 9 vjeçar publik	46
Tab. 6 Nxënës të regjistruar në arsimin 9 vjeçar publik, cikli i ulët	46
Tab. 7 Nxënës të diplomuar në arsimin 9 vjeçar	47
Tab. 8 Nxënës të diplomuar në arsimin 9 vjeçar publik	47
Tab. 9 Shkolla të mesme	48
Tab. 10 Shkolla të mesme publike	48
Tab. 11 Mësues në shkollat e mesme	49
Tab. 12 Mësues në shkollat e mesme publike	49
Tab. 13 Nxënës të regjistruar në arsimin e mesëm	50
Tab. 14 Nxënës të regjistruar në arsimin e mesëm publik	50
Tab. 15 Nxënës të regjistruar në gjimnaz	51
Tab. 16 Nxënës të regjistruar në gjimnaze publike	51
Tab. 17 Nxënës të diplomuar në arsimin e mesëm	52
Tab. 18 Nxënës të diplomuar në arsimin e mesëm publik	52
Tab. 19 Nxënës të diplomuar në gjimnaz	53
Tab. 20 Nxënës të diplomuar në gjimnaze publike	53

6. STATISTIKAT E TREGUT TË PUNËS54

Fig. 1 Ndryshimi në përqindje të punësimit në sektorin privat jo-bujqësor, 2013-2014	55
Fig. 2 Përqindja e të rinjve 15-24 vjeç ndaj punëkërkuarve të papunë të regjistruar, 2013 - 2014	56
Fig. 3 Shpërndarja e punëkërkuarve të papunë të regjistruar sipas nivelit arsimor, 2014	57
Tab. 1 Të punësuar në administratën publike	58
Tab. 2 Të punësuar në sektorin privat jo-bujqësor	58
Tab. 3 Të punësuar në sektorin privat bujqësor	59
Tab. 4 Të punësuar në administratën publike lokale	59
Tab. 5 Të punësuar në administratën publike lokale, komuna	60
Tab. 6 Të punësuar në administratën publike lokale, bashki	60
Tab. 7 Të punësuar në administratën publike lokale, qark	61
Tab. 8 Punëkërkuar të papunë të regjistruar, 2014	61
Tab. 9 Punëkërkuar të papunë të regjistruar, 2013	62
Tab. 10 Punëkërkuar të papunë të regjistruar, 2012	62

Tab. 11 Punëkërkuar të papunë të regjistruar, 2011	63
Tab. 12 Punëkërkuar të papunë të regjistruar, 2010	63
Tab. 13 Punëkërkuar të papunë afatgjatë	64
Tab. 14 Punëkërkuar të papunë afatgjatë, femra	64
Tab. 15 Punëkërkuar të papunë në pagesë papunësie	65
Tab. 16 Punëkërkuar të papunë në pagesë papunësie, femra	65
Tab. 17 Paga mesatare mujore bruto për një të punësuar në sektorin shtetëror	66
Tab. 18 Numri mesatar i familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike	66
Tab. 19 Fondi mesatar mujor i ndihmës ekonomike sipas qarqeve	67

7. ANKETA E MATJES SË NIVELIT TË JETESËS 68

Tab. 1 Treguesit e varfërisë sipas qarqeve (përqindja, hendeku, ashpërsia)	68
Fig. 1 Madhësia mesatare e familjeve të varfëra dhe jo të varfëra	69
Tab. 2 Popullsia në varfëri sipas numrit të fëmijëve që kanë në varësi	69
Tab. 3 Diploma më e lartë e marrë dhe vitet e arsimit për popullsinë 21 vjeç e lart	70
Tab. 4 Përqindja e individëve të varfër sipas arsimit të kryefamiljarit	70
Tab. 5 Kushtet e banimit dhe aksesit në shërbimet bazë	71
Tab. 6 Zotërimi i pajisjeve afatgjata të familjeve	71

8. PRODUKTI I BRENDSHËM BRUTO (PBB) 73

Tab. 1 Treguesit kryesorë ekonomikë, viti 2012	73
Tab. 2 Rritja Reale e PBB-së	74
Fig.1 PBB për frymë sipas qarqeve krahasuar me mesataren e vendit	74
Fig. 2 PBB sipas qarqeve	75
Fig. 3 PBB për frymë sipas qarqeve	76
Tab. 3 Produkti i Brendshëm Bruto me çmime korrente në mln lekë	77
Tab. 4 Produkti i Brendshëm Bruto për frymë në lekë	77
Tab. 5 Produkti i Brendshëm Bruto për frymë	78
Tab. 6 Struktura e Vlerës së Shtuar Bruto (VSHB) sipas degëve të ekonomisë dhe qarqeve, viti 2012*	78
Tab. 7 Struktura e Vlerës së Shtuar Bruto (VSHB) sipas degëve të ekonomisë dhe qarqeve, viti 2012*	79

9. REGJISTRAT E NJËSIVE EKONOMIKE 81

Fig. 1 Shpërndarja e ndërmarrjeve aktive sipas qarqeve	83
Tab. 1 Ndërmarrje aktive, krijuar të reja dhe shkalla e lindshmërisë	84
Tab. 2 Ndërmarrjet aktive sipas qarqeve	84
Fig. 1 Numri i ndërmarrjeve aktive sipas viteve dhe qarqeve	85
Fig. 2 Numri i ndërmarrjeve aktive me pronarë / administratore femër sipas viteve dhe qarqeve	85
Tab. 3 Ndërmarrjet e reja sipas qarqeve	86
Fig. 3 Numri i ndërmarrjeve të reja sipas viteve dhe qarqeve	86
Fig. 4 Numri i ndërmarrjeve të reja me pronarë / administratore femër sipas viteve dhe qarqeve	87
Tab. 4 Shkalla e lindshmërisë së ndërmarrjeve të reja sipas qarqeve	87
Tab. 5 Ndërmarrjet aktive sipas qarqeve dhe formës ligjore	88
Tab. 6 Ndërmarrjet aktive sipas qarqeve dhe pronësisë	89
Tab. 7 Ndërmarrjet aktive sipas qarqeve dhe madhësisë	90
Tab. 8 Ndërmarrjet aktive sipas qarqeve dhe aktivitetit ekonomik	91

10. TURIZMI 94

Fig.1 Hyrjet e shtetasve të huaj dhe daljet e shtetasve shqiptarë sipas qarqeve, viti 201494

Tab.1 Hyrjet dhe daljet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas qarqeve dhe mënyrës së udhëtimit 95

11. TRANSPORTI 96

Fig. 1 Numri i mjeteve për pasagjerë sipas qarqeve, për mijë banorë 96

Tab. 1 Mjetet e transportit rrugor të pasagjerëve 97

Tab. 2 Mjetet e transportit rrugor të mallrave 98

Fig. 2 Numri i pasagjerëve sipas qarqeve në transportin detar, 2010-201499

Tab. 3 Transporti detar i pasagjerëve99

Fig. 3 Volumi i ngarkim shkarkimit sipas qarqeve100

Tab. 4 Volumi i punës së ngarkim shkarkimit, 2010-2014 100

Tab. 5 Tregues të transportit ajror101

Tab. 6 Tregues të transportit hekurudhor101

Fig. 4 Të aksidentuar për 10.000 banorë, 2014 102

Tab. 7 Aksidentet rrugore 103

12. LEJET E NDËRTIMIT105

Fig.1 Numri i lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesa të reja105

Tab.1 Lejet e ndërtimit miratuar për ndërtesa të reja sipas qarqeve 106

Tab. 2 Lejet e ndërtimit miratuar për banesa sipas qarqeve, 2010-2014106

Fig. 2 Sipërfaqja për ndërtesa të reja sipas lejeve të ndërtimit të miratuara107

Tab. 3 Sipërfaqja për ndërtesa të reja sipas lejeve të ndërtimit të miratuara sipas qarqeve, 2010-2014 107

Tab. 4 Sipërfaqja për banesa sipas lejeve të ndërtimit të miratuara sipas qarqeve, 2010-2014 108

13. BUJQËSIA 109

Tab. 1 Përdorimi i tokës, 2009-2013 111

Fig. 1 Përdorimi i tokës, 2013 111

Tab. 2 Sipërfaqja e mbjellë me bimë arrash, 2009-2013112

Tab. 3 Sipërfaqja e mbjellë me drithra, 2009-2013 113

Tab. 4 Sipërfaqja me bimë të tjera në tokë arë, 2009-2013 114

Tab. 5 Prodhimi i drithrave, 2009-2013115

Tab. 6 Prodhimi i bimëve të tjera në tokë arë, 2009-2013116

Tab. 7 Rendimenti i drithrave, 2009-2013 117

Fig. 2 Prodhimi i drithrave sipas qarqeve, 2013118

Tab. 8 Rendimenti i bimëve të tjera në tokë arë, 2009-2013 119

Tab. 9 Numri i pemëve në prodhim të kulturave drufrutore, 2009-2013120

Tab. 10 Prodhimi i kulturave drufrutore, 2009-2013 121

Tab. 11 Rendimenti i kulturave drufrutore, 2009-2013122

Fig. 3 Prodhimi i pemëve frutore sipas qarqeve, 2013 123

Fig. 4 Prodhimi i ullirit sipas qarqeve, 2013 124

Fig. 5 Prodhimi i rrushit sipas qarqeve, 2013 125

14. BLEGTORIA 126

Tab. 1 Bagëtitë, shpendët dhe bletët, 2009-2013	127
Fig. 1 Numri i krerëve të bagëtive	128
Tab. 2 Prodhime blegtorale, 2009-2013	129
Fig. 2 Prodhimi i qumështit	130
Fig. 3 Prodhime blegtorale	130
Tab. 3 Prodhime blegtorale, 2009-2013	131
Fig. 4 Mish peshë e gjallë	131
Tab. 4 Përpunimi i produkteve kryesore blegtorale, agroindustri, 2009-2013	132
Fig. 5 Përpunimi i produkteve kryesore blegtorale	132
Tab. 1 Zënie peshku, 2009-2013	134

POPULLSIA

Hyrje

Popullsia e Shqipërisë ka ardhur duke u zvogëluar pas vitit 1990. Ritmi i rënies së popullsisë ka qenë më i lartë gjatë viteve 2001- 2010, ndërkohë që pas vitit 2010 ritmi i rënies së popullsisë është zvogëluar. Në këtë rënie të popullsisë një ndikim të konsiderueshëm ka migracioni neto dhe më pak shtesa natyrore e popullsisë. Ndërkohë që komponenti i parë vazhdon të mbetet negativ, i dyti edhe pse është pozitiv, ka pësuar rënie gjatë periudhës në fjalë.

Ndryshimet demografike në Shqipëri do të sjellin ndryshime të konsiderueshme në dekadën e ardhshme. Ashtu siç parashikojnë projeksionet e popullsisë (2011-2031), popullsia e Shqipërisë do të përfshijë ulje të numrit të lindjeve dhe shtesa e saj natyrore do të barazohet me zero – pra lindjet do të barazohen me numrin e vdekjeve, në vitin 2027.

Gjithashtu migracioni nga ana tjetër luan një rol shumë të rëndësishëm në dinamikën e popullsisë, ku Shqipëria vazhdon dhe do të vazhdojë të përfshijë flukse dalëse të popullsisë. Këto flukse do të kompensohen sado pak nga

migracioni i kthimit edhe në vitet në vazhdim ashtu sikurse sugjerojnë projeksionet e popullsisë.

Në këtë mënyrë popullsia e Shqipërisë po shkon drejt procesit të plakjes si pasojë e uljes së lindshmërisë dhe rritjes së jetëgjatësisë dhe për më tepër emigracionit i cili vazhdon të mbetet veprues dhe që përfshin një popullsi relativisht të re.

Pavarësisht rënies së popullsisë, ky fakt nuk mund të përgjithësohet për të gjitha qarqet. Ka qarqe të cilat gjatë pesë viteve të fundit kanë pësuar rritje të numrit të popullsisë ku mund të përmendim qarkun e Tiranës, qark i cili gjatë periudhës në fjalë është karakterizuar nga norma rritjeje pozitive të popullsisë, i ndjekur nga Durrësi, për të cilin përjashtim bën viti 2013 ku shënon rënie të numrit të popullsisë. Rritja e popullsisë në këto dy qarqe i dedikohet kryesisht lëvizjeve të brendshme, të cilat kanë patur destinacion këto dy qarqe. Ndërkohë që qarqet e tjera të vendit kanë pësuar një rënie në numrin e popullsisë.

Tab.1 Popullsia mesatare sipas gjinisë dhe qarqeve, 2010-2014

Qarqet	2010			2011			2012		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
Shqipëria	2.913.019	1.457.661	1.455.358	2.904.776	1.455.073	1.449.703	2.900.487	1.455.904	1.444.583
Berat	151.375	76.225	75.150	148.161	74.564	73.597	145.943	73.608	72.335
Dibër	146.134	74.283	71.851	142.491	72.535	69.956	139.619	71.276	68.344
Durrës	267.712	134.352	133.360	272.021	136.754	135.267	274.865	138.621	136.244
Elbasan	308.298	155.333	152.966	306.040	153.975	152.065	304.130	153.260	150.870
Fier	327.621	165.269	162.352	322.540	163.050	159.490	319.159	161.724	157.435
Gjirokastrë	80.322	40.508	39.814	76.563	38.745	37.818	74.174	37.621	36.553
Korçë	232.040	116.826	115.214	228.794	115.562	113.232	226.805	114.782	112.024
Kukës	90.313	45.439	44.874	88.621	44.651	43.970	87.198	44.046	43.153
Lezhë	140.245	70.002	70.243	139.363	69.673	69.690	138.671	69.555	69.116
Shkodër	227.344	112.444	114.900	224.021	111.131	112.891	221.977	110.341	111.636
Tiranë	755.366	373.420	381.946	772.290	381.963	390.327	785.075	388.926	396.149
Vlorë	186.252	93.563	92.690	183.874	92.471	91.403	182.874	92.146	90.728

vazhdon

Qarqet	2013			2014		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
Shqipëria	2.897.365	1.458.648	1.438.717	2.894.476	1.460.984	1.433.492
Berat	145.167	73.436	71.731	143.888	73.003	70.886
Dibër	138.386	70.855	67.531	137.399	70.669	66.730
Durrës	275.338	139.274	136.065	275.698	139.804	135.895
Elbasan	302.974	153.134	149.840	302.112	153.331	148.782
Fier	317.951	161.591	156.360	316.406	161.200	155.206
Gjirokastrë	73.592	37.437	36.155	72.879	37.113	35.766
Korçë	226.174	114.803	111.372	225.116	114.593	110.523
Kukës	86.514	43.831	42.683	85.967	43.696	42.271
Lezhë	138.282	69.568	68.714	137.514	69.456	68.058
Shkodër	221.347	110.362	110.986	219.879	109.833	110.047
Tiranë	788.730	391.920	396.810	794.658	395.718	398.940
Vlorë	182.914	92.441	90.473	182.963	92.572	90.391

Gjetjet kryesore

Dendësia e popullsisë

Qarku i Tiranës shënon dendësinë e popullsisë më të lartë në vend, mbi 480 banorë për kilometër katror, në vitin 2014.

Dendësia e popullsisë në mes të vitit 2014 është 100.7 banorë për km², vlerë e cila ka pësuar ndryshime shumë të vogla në pesë vitet e fundit. Figura 1 paraqet diversitetin e dendësisë sipas qarqeve - ku vetëm 3 qarqe kanë dendësi mbi 150 banorë për km². Mund të themi se dendësitë më të larta të popullsisë janë përqëndruar në zonat qendrore të vendit. Qarku i Tiranës i cili përfshin edhe kryeqytetin e Shqipërisë ka dendësinë më të lartë me 481 banorë për km² në vitin 2014. Qarku i dytë me dendësinë më të lartë është


Durrësi me 360 banorë për km² dhe pasohet nga qarku i Fierit me 167 banorë për km² në vitin 2014.

Nga ana tjetër, vetëm në dy qarqe dendësia është nën 40 banorë për km². Dendësia më e ulët përqendrohet në zonat më periferike të vendit tonë, në verilindje qarku i Kukësit dhe në juglindje qarku i Gjirokastrës ku shënohet edhe dendësia më e ulët e territorit të Shqipërisë rreth 25 banorë për km² në vitin 2014. Figura 1 më poshtë paraqet dendësitë për 12 qarqet e vendit ku ngjyra e errët tregon qarqet me dendësi më të lartë, ndërkohë ngjyra më e lehtë qarqet me dendësi më të ulët.

Tab. 2 Dendësia e popullsisë, 2014

Qarqet	Popullsia	Dendësia
Shqipëria	2.894.476	100,7
Berat	143.888	80,0
Dibër	137.399	53,1
Durrës	275.698	359,9
Elbasan	302.112	94,4
Fier	316.406	167,4
Gjirokastrë	72.879	25,3
Korçë	225.116	60,7
Kukës	85.967	36,2
Lezhë	137.514	84,9
Shkodër	219.879	61,7
Tiranë	794.658	481,0
Vlorë	182.963	67,6

Fig. 1 Dendësia e popullsisë 2014



Struktura e popullsisë

Pesha që zënë të moshuarit (65+) në popullsi gjatë këtyre pesë viteve ka tendencë në rritje.

Në vitin 2014, në totalin e popullsisë mesatare të Shqipërisë, të rinjtë (0-14vjeç) zënë 18.9% të popullsisë gjithsej, ndërsa

popullsia në moshë pune (15-64vjeç) llogaritet rreth dy të tretat (68.9%) e popullsisë gjithsej, duke lënë kështu vetëm 12.2% të popullsisë gjithsej për popullsinë në moshë 65 vjeç e lart.

Tab. 3 Popullsia mesatare sipas grupmoshës dhe gjinisë, 2014

Qarqet	Gjithsej			Meshkuj			Femra		
	0-14	15-64	65+	0-14	15-64	65+	0-14	15-64	65+
Shqipëria	546.473	1.993.770	354.232	284.766	1.005.921	170.298	261.708	987.850	183.935
Berat	27.568	98.660	17.660	14.308	50.164	8.530	13.260	48.495	9.130
Dibër	26.815	93.644	16.940	13.943	48.437	8.289	12.872	45.207	8.650
Durrës	50.571	191.604	33.523	26.958	96.642	16.204	23.614	94.962	17.319
Elbasan	58.156	206.819	37.137	30.098	105.291	17.941	28.058	101.528	19.196
Fier	60.790	216.745	38.871	31.624	110.726	18.850	29.166	106.019	20.021
Gjirokastrë	13.859	50.090	8.929	7.255	25.529	4.329	6.605	24.561	4.600
Korçë	43.326	154.123	27.667	22.499	78.687	13.407	20.827	75.435	14.261
Kukës	16.617	58.774	10.575	8.591	29.989	5.115	8.026	28.785	5.460
Lezhë	25.826	94.885	16.803	13.510	47.861	8.085	12.316	47.024	8.719
Shkodër	42.057	150.841	26.981	21.515	75.486	12.831	20.542	75.354	14.150
Tiranë	146.791	551.046	96.821	76.514	273.249	45.956	70.278	277.797	50.865
Vlorë	34.097	126.540	22.326	17.953	63.858	10.761	16.144	62.682	11.565

Figura 2 tregon strukturën e popullsisë së 12 qarqeve të vendit tonë, duke marrë në konsideratë tre grupmoshat e mëdha të popullsisë. Nga figura 2 shihet qartë përpjesa që zë secila grupmoshë në popullsinë respektive të çdo qarq. Peshën më të madhe në popullsinë e secilit qark në vitin 2014, e zë grupmosha (15-64), pra popullsia në moshë pune, e cila pasohet nga grupmosha e të rinjve (0-14), ndërkohë që peshën më të ulët e zë grupmosha e të moshuarve (65+).

Të dhënat tregojnë për një strukturë popullsie pothuajse të njëjtë në të gjitha qarqet. Diferenca mjaft të vogla mund të vihen re tek grupmosha e të rinjve, ku qarku i Durrësit shënon përqindjen më të ulët të popullsisë së të rinjve prej 18.3 %, ndërkohë që vlera më e lartë shënohet në qarkun e Dibrës ku të rinjtë zënë rreth 19.5 % të popullsisë për vitin 2014. Për sa i përket grupmoshës së të moshuarve vihen re diferenca të papërfillshme në 12 qarqet e vendit.

Fig. 2 Struktura e popullsisë së qarqeve, sipas tre grupmoshave të mëdha, 2014



Raporti i varësisë moshore

Ndryshimet strukture të popullsisë së Shqipërisë mund të analizohen edhe më tepër nëse marrim në konsideratë raportet e varësisë moshore, të cilat llogariten duke krahasuar numrin e personave të varur (të rinjtë 0-14 vjeç dhe/ose të moshuarit 65+ vjeç) me popullsinë në moshë pune. Këto raporte llogariten për të siguruar informacion lidhur me barrën që mund t'i adresohet popullsisë në moshë pune (15-64 vjeç).

Raporti i varësisë së të moshuarve: një peshë gjithnjë e në rritje ndaj popullsisë në moshë pune.

Raporti i varësisë së të moshuarve llogaritet si raport i popullsisë 65+ vjeç ndaj popullsisë në moshë pune 15-64 vjeç; ky raport në Shqipëri është 17.8 % në vitin 2014

kundrejt 16.2 % në vitin 2010. Pra raporti i varësisë së të moshuarve ka një tendencë në rritje me kalimin e viteve. Ky raport shënon vlerën më të lartë në qarkun e Dibrës, 18.1 % dhe vlerën më të ulët në qarkun e Durrësit me 17.5 %.

E kundërta mund të thuhet për raportin e varësisë së të rinjve i cili llogaritet si raport i popullsisë nën 15 vjeç ndaj popullsisë në moshë pune 15-64 vjeç. Ky raport në totalin e popullsisë në vitin 2014 është 27.4 % kundrejt 32.9 % në vitin 2010. Qartazi vihet re një tendencë në rënie e këtij raporti në vendin tonë. Qarku me raportin e varësisë së të rinjve më të ulët renditet Durrësi dhe me atë më të lartë qarku i Dibrës, respektivisht 26.4 % dhe 28.6 %.

Tab. 4 Raportet e varësisë, 2014

Qarqet	Raporti i varësisë së të rinjve	Raporti i varësisë së të moshuarve	Raporti i varësisë së përgjithshme
Berat	27,9	17,9	45,8
Dibër	28,6	18,1	46,7
Durrës	26,4	17,5	43,9
Elbasan	28,1	18,0	46,1
Fier	28,0	17,9	46,0
Gjirokastrë	27,7	17,8	45,5
Korçë	28,1	18,0	46,1
Kukës	28,3	18,0	46,3
Lezhë	27,2	17,7	44,9
Shkodër	27,9	17,9	45,8
Tiranë	26,6	17,6	44,2
Vlorë	26,9	17,6	44,6

Ndryshimi i popullsisë

Nga 1 Janari 2010 deri në 1 Janar të 2015 popullsia e vendit tonë është zvogëluar me rreth 26 mijë banorë, ekuivalente kjo me një normë rritjeje prej -0,2 % në çdo vit. Ndryshimet në popullsi vijnë si rezultat i dy komponentëve: shtesës natyrore të popullsisë dhe migracionit neto. Këto komponentë mund të kombinohen në mënyrë që të kemi rritje të popullsisë (migracion neto pozitiv dhe shtesa natyrore në rritje) ose rënie të popullsisë (migracion neto negativ dhe shtesë natyrore në rënie) ose mund të kundërshtojnë njëri-tjetrin duke sjellë në këtë mënyrë një ndryshim të popullsisë në drejtim të kundërt.

Migracioni neto negativ ka luajtur një rol thelbësor në rënien e popullsisë në vendin tonë, por pavarësisht kësaj shtesa natyrore edhe pse vazhdon të jetë pozitive dhe nuk mund të plotësojë boshllëkun që shkakton migracioni neto, ka arritur në rënie.


Figura 3 jep një paraqitje të dy koeficientëve mesatarë të ndryshimit të popullsisë dhe shtesës natyrore për secilin qark për vitet 2010-2014. Për të mundësuar një krahasim Figura 3 përfshin edhe koeficientët mesatar të ndryshimit gjithsej të popullsisë dhe shtesës natyrore për vitet 2010-2014. Gjithashtu në Figurën 3 tregohet se koeficienti mesatar i ndryshimit gjithsej të popullsisë është negativ (në nivelin 0,2 %), ndërkohë që koeficienti i ndryshimit të popullsisë

për qarqet shënon vlera më të ulta apo më të larta. Qarqet të cilat shënojnë një koeficient të ndryshimit të popullsisë më të lartë se ai i vendit, madje edhe pozitiv janë Tirana dhe Durrësi, përkatësisht 1,4 % dhe 0,8 %. Nga ana tjetër të gjithë qarqet e tjera shënojnë një koeficient të ndryshimit të popullsisë më të ulët. Koeficientin më të ulët të ndryshimit të popullsisë e ka qarku i Gjirokastrës me -2,6%.

Koeficienti i ndryshimit mesatar të shtesës natyrore 2010-2014 për secilin qark në krahasim me koeficientin gjithsej të ndryshimit të shtesës natyrore ka ndryshime të lehta. Këtu mund të veçojmë qarkun e Kukësit i cili ka një ndryshim të dukshëm, ku koeficienti i ndryshimit të shtesës natyrore është më i lartë se koeficienti gjithsej i ndryshimit të shtesës natyrore. E kundërta ndodh me qarkun e Gjirokastrës ku ky koeficient është më i ulët se ai në nivel vendi, madje negativ.

Figura 3 pasqyron të dy këta koeficientë për të mundësuar gjithashtu edhe evidentimin e ndonjë lidhjeje të drejtpërdrejtë midis ndryshimit të popullsisë dhe ndryshimit të shtesës natyrore. Siç mund të vihet re nga Figura 3 jo doemosdoshmërisht ndryshimet në shtesën natyrore pasojnë ndryshimet në popullsi. Kjo për faktin se një impakt të rëndësishëm në ndryshimin e popullsisë të qarqeve e jep edhe balanca e migracionit neto si dhe lëvizjet e brendshme të popullsisë.

Fig. 3 Koeficienti i ndryshimit të popullsisë dhe i shtesës natyrore, mesatare 2010-2014




Normat bruto të ndryshimit të popullsisë gjatë këtyre 5 viteve ose thënë ndryshe efektet e kombinuara të shtesës natyrore dhe migracionit neto gjatë 2010-2014, tregohen në Figurën 4. Në këtë periudhë popullsia e Shqipërisë ka rënë mesatarisht çdo vit me 1,8 për mijë banorë. Po të vështrojmë 12 qarqet, gjë e cila jepet nga grafiku i mëposhtëm vetëm 2 qarqe kanë pësuar rritje (Tirana dhe Durrësi) dhe 10 qarqet e tjera kanë pësuar rënie të popullsisë gjatë 2010-2014.

Qarku i Tiranës ka rritjen më të lartë, mesatarisht me 1,4 % çdo vit në periudhën 2010-2014 ose e shprehur me terma absolut rreth mbi 10 mijë banorë i janë shtuar këtij qarku mesatarisht çdo vit në këtë 5-vjeçar.

Nga 10 qarqet të cilat kanë pësuar rënie, 4 prej tyre kanë një rënie më të madhe se 10 për mijë banorë mesatarisht çdo vit, ndërsa 6 qarqet e tjera kanë rënie mesatare në çdo vit më të vogël se 10 për mijë banorë gjatë kësaj periudhe. Qarku i cili regjistron edhe rënien më të madhe gjatë 2010-2014 është ai i Gjirokastrës me 2,7 % mesatarisht në çdo vit. E shprehur kjo në terma absolut ky qark ka pasur një rënie mesatarisht rreth 2 mijë banorë çdo vit në këtë periudhë. Ashtu siç vihet re edhe nga Figura 4 vitet e fundit 2013-2014 këto norma rënie janë ulur, nuk kemi më një rënie prej 48 për mijë banorë në qarkun e Gjirokastrës gjatë 2010-2011 por kjo rënie është ulur mesatarisht në 10 për mijë banorë në 2013-2014.

Fig. 4 Norma bruto e ndryshimit të popullsisë, 2010-2014



Lëvizjet e brendshme të popullsisë


Siç u shpreh edhe më lart ndryshimet e popullsisë së qarqeve, normat e rritjes apo zvogëlimit të popullsisë së tyre ndikohen jo vetëm nga dy komponentët kryesorë të ndryshimit të popullsisë gjithsej, por edhe nga lëvizjet e brendshme të popullsisë.

Gjatë këtyre pesë viteve të fundit, Shqipëria ka përjetuar ndryshime të dukshme. Jo vetëm që popullsia banuese ka pësuar ulje nga 2.913.017 në vitin 2010 në 2.894.476 në vitin 2014, por një pjesë e konsiderueshme e popullsisë ka lëvizur brenda Shqipërisë. Ashtu siç ndodh zakonisht me migracionin, disa grupe të shoqërisë kanë prirje më të madhe për të lëvizur. Kjo ka një impakt të qartë, me një shtrirje të gjerë në përbërjen e popullsisë së qarqeve të ndryshme të Shqipërisë.

Ashtu si në vende të tjera, migracioni i brendshëm në Shqipëri është më së shumti sinonim i urbanizimit. Pjesa më e madhe e njerëzve që ka ndryshuar vendbanimin në pesë vitet e fundit kanë lëvizur në qendrat urbane, që në shumicën e rasteve, përfshijnë kryeqytetin, Tiranën, ose zonat përreth tij. Edhe pse lëvizjet e brendshme janë shumëdimensionale, është e dukshme se shumica dërrmuese e flukseve të migracionit të brendshëm fokusohen drejt Tiranës.

Të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile për vitin 2014 bëjnë të mundur paraqitjen vizuale të migracionit të brendshëm. Figura 5 paraqet të ardhurit dhe të larguarit nga secili qark për vitin 2014.

Fig. 5 Lëvizjet e brendshme të popullsisë, 2014




Siç duket qartë edhe nga Figura 5 është qarku i Tiranës ai që tërheq pjesën më të madhe të migrantëve të brendshëm. Nëse do të flisnim për balancën e migracionit të brendshëm për këtë qark fare mirë do të arrinim në konkluzionin se kjo balance është pozitive, numri i të ardhurve e tejkalon numrin e të larguarve. Po ashtu edhe qarku i Durrësit shënon një balancë pozitive. Edhe pse më të ulët se Tirana, ai vazhdon të jetë një destinacion i preferuar për migrantët e brendshëm.

Janë Berati, Dibra dhe Kukësi qarqe që kanë një balancë të thellë negative të migracionit të brendshëm. Këto qarqe përjetojnë flukse shumë më të larta dalëse të popullsisë sesa flukse hyrëse.

Nëse do të gjykonim normat bruto të migracionit të brendshëm neto, pra raportin e diferencës midis hyrjeve dhe

daljeve nga secili qark me popullsinë përkatëse shprehur për mijë banorë, do të shohim se janë Dibra, Berati dhe Kukësi qarqet që kanë një normë bruto të migracionit neto shumë të ulët, respektivisht - 11,2, - 9,6 dhe - 9,6 për mijë, siç tregon edhe Figura 6. Ndërkohë janë vetëm dy qarqe, Tirana dhe Durrësi që kanë normat bruto të migracionit të brendshëm neto më të lartë, madje janë dhe qarqet e vetme që kanë norma pozitive, respektivisht 9,1 dhe 3,4 për mijë banorë. Pra nëse do të flisnim në terma të përgjithshme, 10 qarqe kanë më tepër flukse dalëse të popullsisë së tyre sesa hyrëse dhe si rrjedhim kanë një normë migracioni neto të brendshme negative, ndërsa nga ana tjetër vetëm në 2 qarqe, Tiranë dhe Durrës, flukset hyrëse tejkalojnë ato dalëse, pra rezultojnë me një normë pozitive të migracionit neto. Me fjalë të tjera, Tirana dhe Durrësi vazhdojnë të jenë qarqet e destinacionit kryesor për migrantët e brendshëm.

Fig. 6 Norma bruto e migracionit neto të brendshëm, 2014




Lindjet

Gratë në Shqipëri po linden gjithmonë e më pak fëmijë duke ngadalësuar kështu shtesën natyrore të popullsisë. Ky seksion na prezanton me normat bruto të lindjeve sipas qarqeve (raporti i lindjeve me popullsinë mesatare e shprehur për mijë banorë) dhe me indeksin sintetik të fekonditetit (numri mesatar i fëmijëve për grua). Në vendin tonë norma bruto e lindjeve llogaritet mesatarisht 12 lindje për mijë banorë gjatë periudhës 2010-2014. Vlera më e lartë arrihet në qarkun e Kukësit me 15,3 lindje për mijë banorë, ndjekur nga qarku i Dibrës (14,3).

Normat më të larta të lindshmërisë gjenden në pjesën verilindore të vendit tonë.

Po të shohim Fig. 7 dallojmë vetëm një qark norma e të cilit është më e vogël se mesatarisht 10 lindje për mijë banorë gjatë periudhës 2010-2014, ky është qarku i Gjirokastrës me normën mesatare bruto të lindjeve (9,6). Pjesa qendrore e territorit të Shqipërisë ka norma bruto të lindjeve relativisht të larta duke lëvizur nga 12,1-13,0 lindje për mijë banorë gjatë këtij 5-vjeçari. Qarku i Tiranës dhe Durrësit shënojnë vlerën 12,6 lindje për mijë banorë, duke vijuar me qarkun e Elbasanit (12,4) dhe të Lezhës (12,3). Po të krahasojmë vitin 2010 me vitin 2014, norma bruto e lindjeve në shumicën e qarqeve ka pësuar rritje. Janë vetëm 3 qarqe si ai i Vlorës, Tiranës dhe Kukësit të cilat kanë pësuar rënie mjaft të vogël të këtij treguesi nga 2010 në 2014.

Fig. 7 Norma bruto e lindjeve 2014




Indeksi sintetik i fekonditetit

Indeksi sintetik i fekonditetit arriti vlerat më të ulta të tij prej 1,58 lindje të gjalla për grua në vitin 2008; më pas ky tregues filloi të pësojë rritje të lehta në 1,63 lindje të gjalla për grua në vitin 2010 dhe deri në 1,76 lindje të gjalla për grua në vitin 2014. Norma prej 2,1 lindje të gjalla për grua konsiderohet si lindshmëria e nivelit të zëvendësimit për pjesën më të madhe të vendeve të zhvilluara. E thënë me fjalë të tjera në këto norma do të kishim një popullsi stacionare (të qëndrueshme) në afatin e gjatë, nëse nuk marrim parasysh flukset hyrëse apo dalëse të migracionit.

Ashtu sikurse mund të shohim edhe nga Figura 8 shumica e qarqeve është poshtë nivelit të zëvendësimit, me indeks sintetik fekonditeti më të vogël se 2,1 lindje të gjalla për grua në vitin 2014. Vlera më e lartë e indeksit sintetik të fekonditetit arrihet në qarkun e Dibrës me 2,6 lindje të gjalla për grua në vitin 2014, ndjekur nga qarku i Kukësit me 2,3 lindje të gjalla për grua.

Gjatë vitit 2014 qarku i Vlorës shënon vlerën më të ulët prej 1,4 lindje të gjalla për grua.

Fig. 8 Indeksi sintetik i fekonditetit, 2014



Ndryshimet në rang qarku të ISF-së mund të jenë të lidhura me një sërë faktorësh, përveç të tjerave: struktura socio-ekonomike e popullsisë (si psh. niveli arsimor, statusi i

punësimit, të ardhurat ose mosha); ose faktorë kulturor (si psh. traditat dhe besimet fetare, perceptimet ndaj lindjeve jashtë martesore ose qëndrimet kundrejt kontraceptivëve).

Vdekjet

Regjistrohen në zyrat e gjendjes civile rreth 21 mijë të vdekur gjithsej në vendin tonë në vitin 2014, e cila është 1,9% më shumë vdekje se një vit më parë ose 2,7% më shumë vdekje krahasuar me vitin 2010. Norma bruto e vdekjeve në Shqipëri mesatarisht gjatë periudhës 2010-2014 llogaritet 7 vdekje për mijë banorë, duke u luhatur nga 10,7 vdekje për mijë banorë në qarkun e Gjirokastrës, 9,2 vdekje për mijë banorë në qarkun e Korçës, deri në më pak se 6 vdekje për mijë banorë në qarkun e Kukësit dhe Tiranës.

Figura 9 prezanton informacion për moshën mesatare të vdekjeve për çdo qark në vitin 2014 duke e krahasuar me moshën mesatare të vdekjeve gjithsej në Shqipëri për të njëjtin vit. Siç tregon edhe figura më poshtë moshë mesatare e vdekjeve gjithsej në vitin 2014 është 72,6 vjeç, ndërkohë që ka luhatje të dukshme nëse shohim moshën mesatare për secilin qark. Është qarku i Kukësit ai që ka një shmangie të dukshme nga moshë mesatare gjithsej, duke

u klasifikuar kështu në qarkun me moshën mesatare më të ulët të vdekjeve 68 vjeç. E kundërta ndodh me qarkun e Gjirokastrës i cili gjithashtu ka një shmangie nga moshë mesatare gjithsej, por në këtë rast, moshë mesatare e vdekjeve për këtë qark është më e lartë se ajo mesatare gjithsej, përkatësisht 76 vjeç. Pra, janë 6 qarqe me moshë mesatare të vdekjeve më të ulët se ajo mesatare gjithsej dhe 5 qarqe me moshë mesatare të vdekjeve për vitin 2014, më të lartë se ajo mesatare gjithsej. Vetëm qarku i Shkodrës ka moshë mesatare të vdekjeve të barabartë me atë mesatare gjithsej, 72,6 vjeç.

Figura 10 tregon shpërndarjen e normave bruto të vdekjeve në rang qarqesh. Numri i vdekjeve përgjithësisht reflekton strukturën e popullsisë pasi moshat e mëdha kanë me shumë gjasa të vdesin. Ngjyrat e theksuara në hartë tregojnë normat mesatare më të larta bruto të vdekjeve gjatë 2010-2014.

Fig. 9 Moshë mesatare e vdekjeve sipas qarqeve dhe moshë mesatare e vdekjeve gjithsej, 2014





Fig. 10 Norma bruto e vdekjeve 2014




Martestat

Event mjaft i rëndësishëm në shoqërinë e një vendi janë gjithashtu martesat. Në vitin 2014 janë regjistruar në zyrat e gjendjen civile rreth 23 mijë martesa. Shifër kjo e përafërt me një vit më parë, por me një rënie prej 6,5 % krahasuar

me vitin 2010, e shprehur në vlera absolute rreth 1660 martesa më pak. Figura 11 tregon tendencën gjatë 2010-2014 dhe siç vihet re numri i martesave në vendin tonë ka një trend në rënie.


Fig. 11 Numri i martesave gjithsej, 2010-2014



Norma bruto e martesës me fjalë të tjera, numri i martesave për mijë banorë prezantohet në Figurën 12. Në Shqipëri kemi 8,2 martesa për mijë banorë në vitin 2014, ku vlera më

e lartë shihet në qarkun e Lezhës me 9,3 martesa për mijë banorë dhe më e ulta në qarkun e Tiranës dhe Korçës me 7,4 martesa për mijë banorë.

Fig. 12 Norma bruto e martesave sipas qarqeve, 2014



Burimi i të dhënave

INSTAT mbledh një gamë të gjerë të dhënash demografike duke përfshirë statistika të popullsisë në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe të dhëna për eventet demografike të cilat kanë një ndikim në madhësinë dhe në strukturën e popullsisë. Për drejtorinë e statistikave sociale burimet kryesore të të dhënave, për përmbushjen e objektivave në llogaritjen e treguesve specifik janë të dhënat administrative dhe Censuset e Popullsisë dhe Banesave.

Burimet administrative

Lindjet, Vdekjet, Martesat dhe Lëvizjet e brendshme të popullsisë

Të dhënat e lindjeve, vdekjeve, martesave dhe lëvizjet e brendshme dërgohen elektronikisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Kjo mënyrë e dërgimit të të dhënave të eventeve demografike siguron një plotshmëri më të lartë dhe përmbushjen e afateve të publikimeve përkatëse.

Censusi i popullsisë dhe banesave

Censusi i popullsisë dhe banesave, 2011 është një burim mjaft i rëndësishëm për statistikat e popullsisë. Ai shërben si bazë për vazhdimësinë e përlogaritjeve vjetore të numrit të popullsisë.

Përkufizime

Norma bruto e lindjeve: Është numri i lindjeve për 1000 banorë të një territori të caktuar në një vit të dhënë.

Norma bruto e vdekjeve: Është numri i vdekjeve për 1000 banorë të një territori të caktuar në një vit të dhënë.

Statistikat vitale: Janë të dhëna demografike mbi lindjet, vdekjet, vdekjet nën 1 vjeç dhe martesat.

Lindje e gjallë: Lindjet e fëmijëve që shfaqën shenja jete. Është numri i lindjeve që përjashtojnë lindjet e vdekura.

Vdekje: Nënkupton zhdukjen e përhershme të të gjitha shenjave të jetës në çdo kohë pasi ka ndodhur një lindje e gjallë (ndërprerjen e funksioneve vitale pa aftësinë e ringjalljes).

Shtesa natyrore e popullsisë: Shpreh rritjen/rënien e popullsisë si rezultat i proceseve biologjike (lindjeve dhe vdekjeve)

të saj gjatë një periudhe kohe. Pra diferenca midis lindjeve dhe vdekjeve në një vit të caktuar shpreh shtesën natyrore të popullsisë për atë vit.

Densiteti i popullsisë: Quhet numri i banorëve për njësi sipërfaqeje toke (për km²)

Koeficienti i rritjes së popullsisë: Është frekuenca me të cilën një popullsi rritet (ose zvogëlohet) në një vit të dhënë në sajë të rritjes natyrore dhe migracionit neto, shprehur si përqindje e popullsisë bazë.

Koeficienti i rritjes natyrore: Është koeficienti me të cilin një popullsi po rritet (ose zvogëlohet) në një vit të dhënë në sajë të shtesës së lindjeve mbi vdekjet, shprehur si përqindje ndaj popullsisë bazë.

Raporti i varësisë së përgjithshme: Raporti i numrit të personave nën moshën e punës (0-14 vjeç) dhe personave të vjetër mbi moshën e punës (65+ vjeç), me numrin e personave që janë në moshë për të punuar (nga 15 deri në 64 vjeç) shprehur në përqindje.

Raporti i varësisë së të rinjve: Raporti i numrit të personave nën moshën e punës (0-14 vjeç), me numrin e personave që janë në moshë për të punuar (nga 15 deri në 64 vjeç), shprehur në përqindje.

Raporti i varësisë së të moshuarve: Raporti i numrit personave të vjetër mbi moshën e punës (65+ vjeç), me numrin e personave që janë në moshë për të punuar (nga 15 deri në 64 vjeç), shprehur në përqindje.

Migracioni neto i brendshëm: Është diferenca e flukseve hyrëse me ato dalëse të popullsisë së një territori të caktuar (qark) në një vit të dhënë.

Norma bruto e lëvizjeve të brendshme të popullsisë: Është raporti i migracionit neto të brendshëm për një territor të caktuar (qark) me popullsinë përkatëse në një vit të caktuar, shprehur për mijë banorë.

Migracioni neto: Është diferenca midis imigracionit dhe emigracionit të popullsisë së një territori të caktuar në një periudhë të dhënë kohe.

Norma bruto e martesave: Është numri i martesave për 1000 banorë të një territori të caktuar në një vit të dhënë.

Tab. 5 Popullsia mesatare sipas qarqeve dhe zonave urbane dhe rurale, 2010-2014

Qarqet	2010			2011			2012		
	Gjithsej	Urbane	Rurale	Gjithsej	Urbane	Rurale	Gjithsej	Urbane	Rurale
Shqipëria	2.913.018	1.541.308	1.371.710	2.904.776	1.564.138	1.340.638	2.900.486	1.595.699	1.304.787
Berat	151.375	66.631	84.744	148.160	65.252	82.908	145.942	64.207	81.735
Dibër	146.135	36.709	109.426	142.491	36.373	106.118	139.619	36.209	103.410
Durrës	267.712	198.618	69.093	272.021	205.995	66.025	274.865	214.689	60.176
Elbasan	308.298	120.305	187.993	306.039	119.132	186.907	304.130	118.536	185.594
Fier	327.621	128.469	199.152	322.540	128.232	194.307	319.159	128.609	190.550
Gjirokastrë	80.321	38.866	41.454	76.562	38.133	38.429	74.173	37.591	36.583
Korçë	232.041	91.074	140.966	228.794	89.945	138.848	226.805	89.259	137.545
Kukës	90.313	29.604	60.709	88.620	29.690	58.930	87.198	29.920	57.278
Lezhë	140.244	73.891	66.353	139.363	76.657	62.706	138.671	79.915	58.755
Shkodër	227.342	98.728	128.614	224.021	98.454	125.567	221.977	98.663	123.314
Tiranë	755.366	538.315	217.051	772.291	555.040	217.251	785.075	575.137	209.938
Vlorë	186.251	120.099	66.152	183.873	121.232	62.641	182.873	122.964	59.909

vazhdon

Qarqet	2013			2014		
	Gjithsej	Urbane	Rurale	Gjithsej	Urbane	Rurale
Shqipëria	2.897.365	1.633.617	1.263.748	2.894.476	1.653.100	1.241.376
Berat	145.167	63.381	81.786	143.888	62.974	80.915
Dibër	138.386	36.158	102.228	137.399	36.134	101.265
Durrës	275.338	224.413	50.925	275.698	229.406	46.293
Elbasan	302.974	118.317	184.657	302.112	118.216	183.897
Fier	317.951	129.391	188.560	316.406	129.792	186.614
Gjirokastrë	73.592	37.174	36.418	72.879	36.969	35.910
Korçë	226.174	88.863	137.311	225.116	88.670	136.446
Kukës	86.514	30.245	56.269	85.967	30.409	55.558
Lezhë	138.282	83.562	54.720	137.514	85.435	52.080
Shkodër	221.347	99.192	122.156	219.879	99.463	120.416
Tiranë	788.730	597.821	190.909	794.658	609.444	185.214
Vlorë	182.914	125.102	57.811	182.963	126.190	56.772

PROJEKSIONET

Hyrja

Për herë të parë projeksionet e popullsisë së Shqipërisë u publikuan edhe në nivel qarku. Përveç vlerësimit të lindshmërisë, vdekshmërisë dhe migrimit ndërkombëtar, problemi i projeksioneve në nivel qarku përfshin detyrën e vështirë të llogaritjes dhe parashikimit të lëvizjeve të brendshme dhe përqëndrimit të tyre hapësinor.

Në këtë kuadër projeksionet e popullsisë në nivel qarku u bazuan mbi skenarin e mesëm të projeksioneve në nivel kombëtar (lindshmëri e mesme, vdekshmëri e mesme dhe migrim ndërkombëtar i mesëm). Hipotezat për këto komponente demografike u ndërtuan në mënyrë të tillë që t'i korrespondojnë atyre në nivel kombëtar, gjithmonë duke u mbajtur parasysh diferencat rajonale. Për sa i përket

lëvizjeve të brendshme u ndërtuan tre hipoteza të emërtuara si e lartë, e mesme dhe e ulët. Në hipotezën e mesme normat e lëvizjeve të brendshme janë mbajtur konstante dhe janë të barabarta me ato të vëzhguara gjatë periudhës 2007 – 2011. Këto hipoteza janë kombinuar me hipotezat e përqëndrimit hapësinor, të cilat përfshijnë përqëndrim konstant drejt qendrave të mëdha ekonomike, veçanërisht zonës Tiranë – Durrës dhe shpërqëndrim hapësinor të migrantëve të brendshëm drejt qendrave të tjera. Varianti kryesor i projeksioneve në nivel qarku, rezultatet e të cilit janë dhënë më poshtë, është varianti me lindshmëri të mesme, vdekshmëri të mesme, migrim ndërkombëtar të mesëm, migrim të brendshëm konstant dhe përqëndrim hapësinor konstant.

Tab. 1. Projeksionet e popullsisë sipas gjinisë, 2011 - 2031

Qarqet	Gjithsej					Femra				
	2011	2016	2021	2026	2031	2011	2016	2021	2026	2031
Shqipëria	2.907.362	2.888.996	2.863.311	2.827.569	2.782.309	1.451.690	1.423.372	1.405.910	1.390.550	1.369.680
Berat	149.672	138.625	129.354	121.017	113.370	74.392	67.241	62.158	58.047	54.201
Dibër	144.195	129.434	116.812	105.741	95.680	70.884	62.136	55.431	49.956	44.928
Durrës	269.784	275.017	278.305	279.954	279.796	134.370	134.462	135.119	135.793	135.596
Elbasan	306.939	290.680	276.326	263.059	250.275	152.512	142.305	134.650	128.278	122.001
Fier	324.864	308.070	293.223	279.070	265.633	160.767	148.353	139.672	132.579	125.714
Gjirokastrë	78.405	70.532	64.136	58.478	53.508	38.753	34.433	31.256	28.594	26.235
Korçë	230.261	224.872	217.996	210.114	201.976	114.001	110.111	106.662	103.231	99.548
Kukës	89.400	80.635	73.423	67.220	61.341	44.398	39.627	35.878	32.776	29.835
Lezhë	139.733	131.871	125.959	120.986	116.345	69.992	64.538	61.118	58.619	56.226
Shkodër	225.547	213.992	204.898	196.915	188.816	113.706	106.884	102.035	98.133	94.133
Tiranë	763.560	833.088	888.786	932.349	965.108	385.921	419.058	446.941	469.902	487.430
Vlorë	185.002	192.180	194.093	192.666	190.461	91.994	94.224	94.990	94.642	93.833

Sipas projeksioneve të popullsisë së Shqipërisë, gjatë periudhës 2011 – 2031, shumica e qarqeve do të kenë rënie të popullsisë, përveç Tiranës, Durrësit dhe Vlorës. Numri i banorëve të qarkut të Tiranës parashikohet të rritet me më shumë se 25 % nga 763.560 në vitin 2011, në 965.108 në 2031. Rritja e popullsisë përgjatë dy dekadave në vazhdim parashikohet të jetë shumë më e kufizuar në qarqet e Durrësit dhe Vlorës, me rreth 3 %.

Rënia më e shpejtë e popullsisë pritet të ndodhë në qarqet e Kukësit dhe Dibrës në veri të vendit dhe në qarkun e Gjirokastrës në jug. Në këto qarqe popullsia pritet të zvogëlohet me rreth 30 % deri në vitin 2031. Pjesa tjetër e qarqeve do të përfshihet nga një rënie e popullsisë që varion nga 10 % në rreth 20 %, deri në vitin 2031.

Fig. 1 Norma e rritjes së popullsisë, 2011 - 2031



Në vitin 2011 vetëm tre qarqe kanë patur më shumë femra se meshkuj, Tirana, Shkodra dhe Lezha. Të gjitha qarqet e tjera kanë patur raportin gjinor më të lartë se 100. Qarku me raportin gjinor më të ulët në 2011 ka qënë Tirana (97,9 meshkuj për 100 femra), ndërsa qarku me raportin gjinor më të lartë ka qënë Dibra (103,4 meshkuj për 100 femra).

Sipas projeksioneve të popullsisë raporti gjinor do të pësojë rritje në të gjitha qarqet deri kur në vitin 2031 vetëm qarku i Tiranës do e ketë atë më të ulët se 100. Parashikohet që në vitin 2031 qarqet me raportin gjinor më të lartë të jenë Dibra (113 meshkuj për 100 femra) e ndjekur nga Fieri (111,3 meshkuj për 100 femra). Qarku me raportin gjinor më të ulët në vitin 2031 pritet të jetë përsëri Tirana (98 meshkuj për 100 femra).

Fig. 2 Raporti gjinor 2011





Fig. 3 Raporti gjinor 2031



STATISTIKAT JURIDIKE

Hyrje

Statistikat juridike janë të rëndësishme për shkaktë rëndësisë sociale që mbartin në vetvete si dhe për shqetësimet e publikut lidhur me to. Këto statistika synojnë të paraqesin të dhëna lidhur me tendencat e kriminalitetit në vend duke përmirësuar punën në luftimin e tyre. Përmirësimi i tyre shihet në rritjen e shkallës së zbulimit të tij nga policia. Këto statistika të krimeve të prezantuara këtu janë vepra të regjistruara nga policia, klasifikimi i të cilave në vepra dhe kundravajtje penale bëhet duke u bazuar në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë. Bëhet fjalë për ngjarje të ndodhura, jo për gjykime të cilat janë në kompetencë të organeve të drejtësisë për të dhënë vendimin. Ky seksion prezanton statistika të fundit lidhur me situatën e krimeve, dhunën në familje, si dhe të dhëna për të burgosurit sipas qarqeve.

Gjetjet kryesore

Veprat penale

Ky seksion flet për situatën e kriminalitetit në rang qarku në vitin 2014 pasqyrë kjo e paraqitur qartë në tabelën 1. Kjo tabelë ilustron numrin e krimeve të evidentuara për disa grupvepra penale, të dhëna këto të siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë. Nga tabela shohim që numrin më

të madh të krimeve për këtë vit e zënë grupveprat "Krimet kundër rendit dhe standardeve të sjelljes", ndjekur më pas me "Krimet ekonomike- financiare". "Krimet kundër pronës" përbën grupveprën me numrin më të ulët të krimeve të evidentuara në të gjitha qarqet.

Në grupveprën "Krimet kundër personit" përfshihen krimet kundër jetës, kundër shëndetit dhe lirisë. Kjo grupveprë është shumë e rëndësishme dhe rëndësi shumë e madhe i kushtohet edhe zbulimit të tyre. Këto krime çënojnë të drejtën e jetës, e drejtë kjo e pacënueshme, e patjetërsueshme dhe askush nuk ka të drejtë të na e privojë këtë të drejtë. Në Shqipëri në vitin 2010 nëse do shpreheshim në terma absolut janë evidentuar 769 "Krimet kundër personit", ndërkohë në vitin 2014 kemi 485 vepra. Në nivel rajonal, Tirana përbën qarkun me numrin më të madh të kësaj grupvepre me 95 krime të evidentuara, e ndjekur nga qarku i Durrësit respektivisht me 66 dhe qarku e Fierit me 54 krime të evidentuara.

Për grupveprat "Krimet kundër pronës", "Krimet kundër drogës", "Krimet kundër rendit dhe standardeve të sjelljes" numrin më të madh të tyre e shënon qarku i Tiranës, ndjekur më pas nga Durrësi.

Tab. 1 Veprat penale, 2014

Qarqet	Kundër personit	Kundër pronës	Krime për trafiket e paligjshme	Krime në fushën e drogës	Krime ekonomike financiare	Krime në fushën e korrupsionit	Krime në fushën e pastrimit të parasë	Akte kundër rendit dhe standardeve të sjelljes
Berat	19	5	12	50	127	54	24	752
Dibër	30	1	5	39	64	58	11	654
Durrës	66	18	57	188	146	23	41	1.508
Elbasan	36	3	82	68	196	195	35	1.387
Fier	54	10	70	73	189	95	34	1.084
Gjirokastrë	10	8	33	169	40	44	31	677
Korçë	39	4	49	120	175	44	26	1.231
Kukës	23	1	16	23	79	60	8	522
Lezhë	32	9	26	43	170	92	14	1.423
Shkodër	39	7	42	65	149	57	31	1.102
Tiranë	95	34	171	565	616	299	108	6.706
Vlorë	42	15	90	130	156	100	29	1.084

Dhuna në familje

Dhuna në familje haset jo vetëm në shoqërinë shqiptare, por është një fenomen shqetësues që i kapërcen të gjithë kufijtë dhe gjendet në të gjitha kulturat. Ky abuzim është edhe një problem shëndetësor që shkakton plagë madje dhe vdekje, ndikon negativisht në intergritetin fizik, psikosocial dhe ekonomik të personit ndaj të cilit ushtrohet dhunë.

Ky fenomen shkaktohet nga faktorë të ndryshëm, si: ndikimi kulturor me rrënjë të thella në traditat e vjetra patriarkale, situatat jetësore jo të shëndosha, diskriminimi gjinor, papunësia, kontrolli ndërbreznor në familje etj.

Dhuna në familje është ende abuzimi më i shpeshtë me të drejtat e njeriut, por ende më pak i njohuri dhe i pranuari në botë. Studime të ndryshme nxjerrin në pah se është e vështirë të masësh nivelin dhe përhapjen e dhunës në familje, pasi ky fenomen zhvillohet brenda familjes dhe konsiderohet si çështje familjare. Si rrjedhojë, ndër faktorët që mund të ndikojnë në raportimin e ulët të dhunës në familje, mund të përmendim p.sh.: turpin, frikën nga ndëshkimi, normat kulturore, stereotipet që ekzistojnë për dhunën në familje etj, ndaj faktet dhe shifrat duhen parë me kujdes, pasi ato jo detyrimisht japin një pasqyrë të qartë lidhur me përhapjen në vend të dhunës në familje.

Pavarësisht vështirësisë së matjes së këtij fenomeni, të dhënat e raportuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, tregojnë se gjatë viteve 2010-2014 ka një rritje të numrit të


raportimeve për dhunën në familje nga 1998 raportime në vitin 2010 në 4121 raportime në vitin 2014, thënë ndryshe rreth 2 herë më shumë raportime se sa në vitin 2010. Pothuajse në të gjitha qarqet vihet re rritje e numrit të raportimeve.

Në rang vendi, në vitin 2014 janë bërë 14,4 për 10 mijë banorë raportime për dhunën në familje. Nëse do të flisnim në nivel qarku, është qarku i Durrësit ai që shënon numrin më të lartë për 10 mijë banorë të numrit të raportimeve (27), i ndjekur nga Korça (22), Tirana (17) dhe Lezha (15,3). Vlerat më të ulta shënohen në qarkun e Shkodrës dhe Dibrës, përkatësisht 6,4 dhe 7,5 raportime për 10 mijë banorë.

Në figurën 1 është paraqitur pesha që zë numri i raportimeve të dhunës në familje për një vit të caktuar në totalin e raportimeve gjatë 2010-2014 të një qarku specifik. Pra për qarkun e Dibrës nga 349 raportime të dhunës në familje gjithsej gjatë 2010-2014, 36,4 % e tyre janë raportuar në vitin 2012. 10 qarqe shënojnë një rritje në numrin e raportimeve nga viti 2010 në 2014, ndërkohë që vetëm qarku i Vlorës dhe Shkodrës kanë pësuar një ulje në numrin e raportimeve.

Në vitin 2011 vihet re përqindja më e ulët e raportimeve për secilin qark. Përgjithësisht bën vetëm qarku i Fierit, i cili gjatë këtij viti shënon edhe vlerën më të lartë të raportimeve për dhunën në familje me rreth 30 %.

Fig. 1 Dhuna në familje 2010-2014



Të burgosurit

Të dhënat për të burgosurit përfshijnë personat e mitur, të rritur dhe shtetasit e huaj të cilët janë dënuar me vendim të formës së prerë në të gjitha llojet e qendrave të burgimit, siç paraqiten në tabelën 2. Nga tabela shihet se në vitin 2014 në total kemi 5453 të burgosur, ndërsa në vitin 2010 numëroheshin 4603, duke treguar në këtë rast një rritje prej 18,5 % në numrin e të burgosurve. Është qarku i Tiranës ai që shënon numrin më të lartë të të burgosurve për të dy vitet në fjalë 2010 dhe 2014, i ndjekur nga Elbasani, Fieri dhe

Durrësi. Nga ana tjetër janë Gjirokastra, Kukësi dhe Dibra qarqet me numrin absolut më të ulët të të burgosurve. Lidhur me të burgosurit e mitur (të burgosur nën 18 vjeç), qarqet me numrin më të madh të tyre janë Durrësi dhe Elbasani. Duke iu referuar tabelës për të burgosurit e rritur, (të burgosurit mbi 18 vjeç), numri më i madh i tyre shënohet në qarqet Tiranë, Elbasan dhe Fier, ndërkohë Gjirokastra dhe Kukësi përfaqësojnë qarqet me numrin më të vogël të të burgosurve të kësaj moshe.


Tab. 2 Të burgosurit sipas dy ndarjeve të mëdha moshore dhe qarqeve, 2010-2014

Qarqet	2010		2011		2012		2013		2014	
	Nën 18 vjeç	Mbi 18 vjeç	Nën 18 vjeç	Mbi 18 vjeç	Nën 18 vjeç	Mbi 18 vjeç	Nën 18 vjeç	Mbi 18 vjeç	Nën 18 vjeç	Mbi 18 vjeç
Shqipëria	102	4.501	121	4.469	97	4.453	107	4.807	101	5.352
Berat	8	313	6	318	8	321	7	352	2	409
Dibër	3	248	4	249	4	253	6	264	3	293
Durrës	32	436	28	429	28	422	31	437	34	494
Elbasan	27	566	33	558	26	551	29	593	31	628
Fier	5	508	8	511	6	522	5	591	4	618
Gjirokastrë	2	148	3	147	3	152	0	176	1	201
Korçë	0	333	4	338	3	331	5	367	2	461
Kukës	0	163	2	168	0	171	2	182	2	293
Lezhë	9	349	11	351	3	349	8	364	3	383
Shkodër	9	371	7	369	6	365	3	383	1	396
Tiranë	7	785	9	762	7	751	5	799	17	842
Vlorë	0	281	6	269	3	265	6	299	1	334

Figura 2 ilustron normën e të burgosurve për të gjitha veprat penale për 10 mijë banorë për vitin 2014, siç shihet fare qartë nga figura, renditja e qarqeve është e ndryshme nga ajo çfarë sygjeron më lart numri absolut i të burgosurve. Kjo normë jep një informacion më të qartë për peshën që zë popullsia e burgosur në totalin e popullsisë së çdo qarqut, shprehur për 10 mijë banorë në vitin 2014. Në këtë

vit në Shqipëri regjistrohen 18,8 të burgosur për 10 mijë banorë. Nga figura shohim që qarku i Kukësit është qarku me normën më të lartë prej 34,4 të burgosur, vlerë kjo e cila është relativisht e lartë në krahasim me normën mesatare në rang vendi. Është qarku i Tiranës ai me normën më të ulët respektivisht me 10,8 të burgosur për 10 mijë banorë.

Fig. 2 Norma e të burgosurve për 10.000 banorë, 2014



Shënim: Përfshihen të gjithë të burgosurit (të dënuar dhe të paraburgosur) si të miturit, të rriturit dhe të huajt, të burgosur për të gjitha veprat penale.


Për të dhënë informacion mbi ecurinë apo normën e ndryshimit të numrit të të burgosurve ndër vite, figura 3, ilustron normën e ndryshimit në numrin e të burgosurve në vitin 2010 dhe 2014. Norma e ndryshimit në numrin e të burgosurve shpreh se me sa përqind është rritur apo ulur numri i të burgosurve në vitin 2014 krahasuar me vitin 2010.

Nga figura shohim që kjo normë ka trend në rritje për vitet në fjalë e vlefshme kjo për secilin qark. Në Shqipëri norma e ndryshimit midis vitit 2010 dhe 2014 është 18,5 %, që do të

thotë se në vitin 2014 kemi 18.5 % më shumë të burgosur sesa në vitin 2010, ose shprehur në terma absolut në 2014 kemi 850 të burgosur më shumë se në vitin 2010.

Qarku i Kukësit ka normën më të lartë të ndryshimit në numrin e të burgosurve midis vitit 2010 dhe 2014 pikërisht me 81%, pra në vitin 2014 Kukësi ka 81 % më shumë të burgosur se në vitin 2010. Është qarku i Shkodrës ai me normën më të ulët respektivisht me 4,5 %.

Fig. 3 Norma e ndryshimit në numrin e të burgosurve, 2010-2014



Burimi i të dhënave

INSTAT publikon të dhëna lidhur me krimet dhe statistikat juridike në vend. Statistikat lidhur me krimet i kemi për një grupveprash penale specifike si dhe për totalin e krimeve. Baza e të dhënave përfshin gjithashtu të dhëna për të burgosurit.

Për këto statistika burime të dhënash në përmbushjen e treguesve të ndryshëm janë të dhënat administrative.

Të dhënat për të burgosurit i sigurojmë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, ndërsa të dhënat për situatën e kriminalitetit në vend (autorë krimesh, viktime), i sigurojmë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, burime këto shumë të rëndësishme për mbarrëvajtjen e punës dhe për përmbushjen e afateve të caktuara.

Përkufizime

Vepra penale: janë shkeljet e ligjit për të cilat parashikohet ndjekje penale. Ato ndahen në krime dhe kundravajtje penale.

Krime kundër personit: përfshihen krimet kundër jetës, krimet kundër shëndetit dhe krimet kundër lirisë së personit.

Krime kundër pronës: përfshihen vjedhje me armë, shkatërrimi i pronës, shtrëngimi më anë të kanosjes për dhënien e pasurisë, vjedhja e bankave dhe krime të tjera lidhur me këtë grupvepër penale.

Krime në fushën e trafiqeve të paligjshme: përfshihen trafikimi i personave, trafikimi i mjeteve motorike, trafikimi i armëve dhe municioneve, prostitucioni etj.

Krime në fushën e drogës: përfshihen prodhimi, kultivimi, shitja e lëndëve narkotike, trafikimi i tyre etj.

Krime ekonomike-financiare: përfshihen krimet në fushën e doganave, tatim-taksave, fallsifikimet dhe mastrimet etj.

Krime në fushën e korrupsionit: përfshihen korrupsioni dhe veprat penale të kryera nga punonjësit shtetërorë.

Akte kundër rendit dhe standardeve të sjelljes: përfshihen akte jo të hijshme që prishin rendin publik, veprat lidhur me lirinë e shprehjes apo kontrollin e shprehjes, akte në kundërshtim me dispozitat rregullative, akte kundër sistemit të drejtësisë etj.

Dhuna në familje: përfshihen ato akte si rrahja, apo vepër tjetër dhune, kanosja serioze për vrasje ose plagosja e rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ish bashkëshort, bashkëjetues apo ish bashkëjetues, fëmijë apo pjestar familjeje, me pasojë cënimin e integritetit fizik, psikosocial dhe ekonomik të tij.

I burgosur: çdo person, shtetas shqiptar, i huaj apo pa shtetësi, i dënuar me burgim me vendim të formës së prerë të gjykatave shqiptare dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare edhe të gjykatave të huaja, duke respektuar kërkesat përkatëse procedurale.

SHËNDETËSIA

Hyrje

Shëndeti është një çështje e një rëndësie të madhe me fjalë të tjera një çështje e jetës dhe vdekjes. Në këtë pjesë do të trajtojmë statistika për institucionet shëndetësore. Ajo gjithashtu paraqet statistika mbi kujdesin shëndetësor, me një analizë të numrit të shtretërve spitalorë dhe shpërndarjen e tyre në bazë qarqesh.

Gjetjet kryesore

Jetëgjatësia në lindje e femrave ishte 80,3 vjet në Shqipëri në vitin 2013, ndërsa e meshkujve ishte 4,0 vjet më i ulët, 76,0 vjet. Jetëgjatësia vazhdon të rritet dhe kjo pjesërisht mund të shpjegojë ndryshimet demografike në strukturën e popullsisë, si dhe stilin e jetesës. Vëmendje e politikave ka qenë gjithnjë e fokusuar në cilësinë e jetës. Vite të

shëndetshme të jetës janë matje e numrit të viteve që një person mund të pritët që të jetojë në një gjendje të shëndetshme (përcaktuar nga mungesa e kufizimeve të funksionimit/paafetësisë). Sipas Raportit të ISHP, "Gjendja Shëndetësore e Popullatës Shqiptare", rezultoni për meshkujt 62,5 vjet ndërsa për femrat 67 vjet.

Shërbimi i kujdesit shëndetësor parësor dhe shërbimi spitalor

Shërbimi i kujdesit shëndetësor parësor është shkalla e parë ku vijnë problemet shëndetësore dhe ku jepet shërbimi. Gjatë këtyre viteve janë konsoliduar institucionet bazë që ofrojnë këto shërbime, si poliklinikat, qendrat shëndetësore, ambulancat dhe shërbimet e veçanta të konsultorit të fëmijëve dhe të gruas, të përfshira në këto institucione.

Fig. 1 Numri i poliklinikave, 2013






Fig. 2 Qendrat shëndetësore, 2013



Sipas Figurës shihet se qarku i Tiranës, Korçës dhe Elbasanit kanë numrin më të lartë të këtyre institucioneve ku është përqëndruar pjesa kryesore e popullsisë (Figura 1 dhe 2). Qytetet e mëdha shpesh duke pasur dhe shërbimet e specializuara në kujdesin parësor, spitalore (për trajtimin e sëmundjeve të rralla ose të llojeve të reja të ndërhyrjeve) kanë përqëndrimin më të madh të institucioneve shëndetësore publike. Fokusi vihet kryesisht tek shërbimet publike dhe siç shihet numri më i madh i spitaleve publike është në Tiranë,

Elbasan, Korçë, Vlorë, Berat, etj. Në përgjithësi, pabarazitë rajonale mund të rezultojnë nga shpërndarja e objekteve shëndetësore në qytetet e mëdha dhe grumbullime të shërbimeve të specializuara unike për vendin. Këto objekte jo vetëm përdoren nga popullsia lokale, por edhe nga njerëz që grumbullohen nga qarqet e tjera për një shërbim më të kualifikuar (Fig.3).


Fig. 3 Numri i spitaleve, 2013



Po e njëjta situatë pasqyrohet dhe me institucionet spitalore, ku qarku i Tiranës ka 7 spitale dhe ndiqet nga qarku i Elbasanit me 6 spitale (Fig.3) dhe më pas qarqet e tjera. Për shumë vite, numri i shtretërve në spitale në Shqipëri ka rënë. Gjatë dekadës së fundit numri i shtretërve në dispozicion në spitale ra me rreth 13% midis 2003 dhe 2013.

Në vitin 2013, dendësia më e lartë e shtretërve spitalorë në dispozicion në spitale është regjistruar në prefekturën e Gjirokastrës (51 shtretër për 10 000 banorë; ndjekur nga Kukësi me 43 shtretër për 10 000 banorë) shih Fig.4, e më rrallë ndjekur nga Dibra, Vlora, Tirana.

Fig. 4 Shtretër për 10.000 banorë, 2013



Duke parë këtë grafik shohim që në disa qarqe si p.sh Gjirokastra ka numrin më të lartë të shtretërve spitalorë për shkak se ka një popullsi më të ulët se qarqet e tjera, po e njëjta situatë mund të thuhet edhe për Kukësin. Megjithatë Tirana ka numrin më të madh të spitaleve dhe shtretërve spitalorë, numri i shtretërve për 10 000 banorë është më i ulët se numri në rang vendi (29). Po e njëjta situatë mund të shpjegohet me Durrësin, Fierin, Beratin, Lezhë, Shkodër ku është e përqëndruar pjesa më e madhe e popullsisë.

Insitucionet e kujdesit shëndetësor parësor, dytësor dhe terciar, në përgjithësi janë të përqëndruara në rajone me dendësi të lartë të popullsisë dhe sidomos në kryeqytet apo qytetet kryesore të qarqeve. Qytetet shpesh herë duke pasur shërbimet e specializuara spitalore për trajtimin e sëmundjeve të rralla ose të llojeve të reja të ndërhyrjeve, kanë përqëndrim të institucioneve.

Tab. 1 Numri i poliklinikave, 2009-2013

	2009	2010	2011	2012	2013
Shqipëria	46	46	46	46	46
Berat	3	3	3	3	3
Dibër	3	3	3	3	3
Durrës	2	2	2	2	2
Elbasan	4	4	4	4	4
Fier	3	3	3	3	3
Gjirokastrë	3	3	3	3	3
Korçë	5	5	5	5	5
Kukës	2	2	2	2	2
Lezhë	3	3	3	3	3
Shkodër	2	2	2	2	2
Tiranë	14	14	14	14	14
Vlorë	2	2	2	2	2

Tab. 2 Qendra shëndetësore, 2009-2013

Qarqet	2009	2010	2011	2012	2013
Shqipëria	624	475	456	421	409
Berat	37	27	23	23	23
Dibër	39	40	40	34	34
Durrës	46	46	45	26	26
Elbasan	64	79	65	53	54
Fier	50	48	49	45	49
Gjirokastrë	38	32	31	37	31
Korçë	39	39	40	39	39
Kukës	29	29	29	27	27
Lezhë	59	32	32	22	25
Shkodër	59	37	37	37	36
Tiranë	133	36	35	48	35
Vlorë	31	30	30	30	30

Tab. 3 Ambulanca, 2009-2013

Qarqet	2009	2010	2011	2012	2013
Shqipëria	1.812	1.927	1.970	1.946	1.998
Berat	131	144	147	147	147
Dibër	158	133	133	164	163
Durrës	87	87	84	85	86
Elbasan	233	223	246	246	246
Fier	195	187	170	143	147
Gjirokastër	172	176	170	168	170
Korçë	219	219	221	214	214
Kukës	118	123	123	125	125
Lezhë	136	133	133	155	155
Shkodër	148	141	159	153	175
Tiranë	108	199	224	224	224
Vlorë	107	162	160	122	146

Tab. 4 Konsultori i fëmijëve, 2009-2013

Qarqet	2009	2010	2011	2012	2013
Shqipëria	2.061	2.090	2.142	2.113	2.100
Berat	135	141	154	154	155
Dibër	188	163	163	163	187
Durrës	127	128	128	127	127
Elbasan	261	262	262	259	259
Fier	238	238	205	205	164
Gjirokastër	178	180	180	180	180
Korçë	239	237	252	250	249
Kukës	61	63	63	62	62
Lezhë	167	166	168	169	169
Shkodër	138	137	137	137	136
Tiranë	191	203	258	240	240
Vlorë	138	172	172	167	172

Tab. 4.1 Konsultori i gruas, 2009-2013

Qarqet	2009	2010	2011	2012	2013
Shqipëria	2.016	2.030	2.077	2.072	2.099
Berat	139	140	150	150	152
Dibër	188	163	163	163	187
Durrës	118	113	112	111	111
Elbasan	251	252	252	249	249
Fier	226	226	205	205	205
Gjirokastrë	167	167	167	167	167
Korçë	231	236	244	245	244
Kukës	61	61	59	62	62
Lezhë	165	164	164	164	164
Shkodër	138	137	137	137	136
Tiranë	195	200	253	253	253
Vlorë	137	171	171	166	169

Tab. 5 Aktiviteti i spitaleve, 2009-2013

Qarqet	Spitale					Shtretër				
	2009	2010	2011	2012	2013	2009	2010	2011	2012	2013
Shqipëria	44	44	44	44	44	8.805	8.707	8.711	8.723	8.283
Berat	4	4	4	4	4	424	416	378	378	360
Dibër	3	3	3	3	3	542	536	552	536	512
Durrës	2	2	2	2	2	476	475	474	474	471
Elbasan	6	6	6	6	6	1.089	1.104	1.096	1.085	1.025
Fier	3	3	3	3	3	706	712	706	706	664
Gjirokastrë	3	3	3	3	3	409	386	399	399	373
Korçë	4	4	4	4	4	772	767	767	772	752
Kukës	3	3	3	3	3	367	372	372	372	372
Lezhë	3	3	3	3	3	348	340	344	340	353
Shkodër	2	2	2	2	2	705	650	705	705	598
Tiranë	7	7	7	7	7	2.217	2.199	2.189	2.241	2.157
Vlorë	4	4	4	4	4	750	750	729	715	646

Tab. 6 Aktiviteti i spitaleve, 2009-2013

Qarqet	Të shtruar					Shtretër për 10 000				
	2009	2010	2011	2012	2013	2009	2010	2011	2012	2013
Shqipëria	265.200	258.407	240.562	247.391	260.727	30	30	30	30	29
Berat	16.438	14.103	13.930	10.832	12.290	27	27	25	26	25
Dibër	13.469	13.144	11.580	11.313	16.406	35	36	38	38	37
Durrës	16.685	17.814	17.725	17.716	18.345	18	18	18	17	17
Elbasan	22.191	20.589	20.442	21.155	19.727	35	36	36	36	34
Fier	23.449	22.538	19.635	20.770	24.781	21	22	22	22	21
Gjirokastrë	9.833	8.163	7.477	7.059	6.814	48	47	51	53	51
Korçë	15.449	15.764	15.163	16.489	16.837	33	33	33	34	33
Kukës	8.742	7.947	7.193	6.994	8.068	39	41	42	42	43
Lezhë	12.869	11.359	10.216	9.407	9.859	24	24	25	24	26
Shkodër	16.249	14.877	13.781	14.236	13.407	30	28	31	32	27
Tiranë	88.375	89.212	84.139	91.966	95.860	30	29	29	29	27
Vlorë	21.451	22.897	19.281	19.454	18.333	40	40	39	39	35

ARSIMI

Hyrje

Statistikat e arsimit mbledhen nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit që është burimi kryesor i të dhënave për të gjitha nivelet e arsimit zyrtar që kryhet në vend.

Në mbledhjen dhe përpunimin e statistikave të arsimit shqiptar përdoret klasifikimi ndërkombëtar standard i arsimit ISCED, aplikuar fillimisht varianti i vitit 1997, sipas rekomandimeve edhe të Eurostat dhe UNESCO-s.

Në bazë të këtyre të dhënave llogariten treguesit sipas niveleve për arsimin parashkollor, arsimin e detyruar në të dy ciklet, arsimin e mesëm gjimnaz dhe profesional, arsimin e lartë bachelor dhe master etj. Treguesit llogariten për vit shkollor/akademik, në nivel vendi ose qarku. Ky publikim paraqet të dhëna dhe tregues kryesorë në të cilin tabelat dhe grafikët japin një pamje të qartë të arsimit parauniversitar në të gjitha qarqet dhe vendin.


Arsimi Parauniversitar përfshin arsimin e organizuar në

kopshte, shkolla 9 vjeçare dhe të mesme. Arsimi i detyruar i cili që nga viti 2004-2005 kaloi nga 8 në 9 vjeçar me dy ciklet përkatësisht 5 dhe 4 vjeçar, ndërsa arsimi i mesëm përfshin gjimnazin dhe arsimin profesional i cili ndahet në të ulët, teknik dhe të lartë. Tabelat në botim i referohen arsimit të mesëm të lartë i cili përbën gjithashtu pjesën kryesore të tij. Nxënësit që përfundojnë arsimin e mesëm të ulët ose teknik kanë të drejtë të vazhdojnë nivelin me të lartë, atë profesional për të përfituar një diplomë të arsimit të mesëm të vlefshëm për të vazhduar studimet e larta.

Nxënësit e arsimit të detyruar përfunduan për herë të parë në vitin 2009 arsimin 9 vjeçar nga 8 vjet që ishte më parë.

Raporti nxënës për mësues i llogaritur për qark në arsimin 9 vjeçar tregon nivelin mesatar të nxënësve të regjistruar në atë qark që i takojnë një mësuesi të qarkut llogaritur sipas cikleve të veçanta.

Fig. 1 Nxënës për një mësues në ciklin e lartë të 9 vjeçares, në arsimin publik dhe privat, 2013 - 2014



*) Në Qarqet Dibër dhe Kukës nuk ka shkolla private të ciklit të lartë 9-vjeçar

Gjetjet kryesore

Në arsimin e mesëm mbizotërojnë të regjistruarit në gjimnaze për të gjitha vitet. Vetëm 18 % e të regjistruarve në arsimin e mesëm në vitin 2013-2014 i përkasin arsimit profesional. Kjo përqindje është edhe më e larta ndër 5 vitet e fundit. Ndërsa në arsimin publik, të regjistruarit e arsimit profesional përbëjnë 19,3 % të totalit të tyre dhe me tendencë rritëse vit pas viti.

Në arsimin e mesëm publik vazhdojnë studimet në sistemin me kohë të plotë 87-90 % e nxënësve, duke filluar nga viti më i hershëm e deri në vitin e fundit. Por janë diplomuar vetëm 9.5% në arsimin e mesëm profesional në vitin shkollor 2013-2014 përkundrejt 90,5 % të diplomuar në gjimnaz, megjithëse të shpërndarë sipas qarqeve këto përqindje marrin vlera të ndryshme.


Duke u nisur nga dy vitet e fundit vendin e parë për arsimin profesional e zenë përkatësisht qarqet Shkodër e Durrës. Gjithmonë 50-55 % e atyre që përfundojnë arsimin e mesëm janë femrat, me trend rritës në vite. Kjo është pothuajse e njëjtë si në shkollat publike edhe private. Gjithashtu në vitin e fundit raporti i diplomimit faktik krahasuar me numrin e atyre që duhet të përfundojnë është i ndryshëm në qytet dhe në fshat. Në arsimin e mesëm publik me kohë të plotë përfunduan me sukses studimet 80,4 % e të regjistruarve në shtator të vitit akademik 2013-2014, ndërsa për fshatin kjo

përqindje është 69, pra kuptohet që interesi për përfundim është më i lartë në qytet. Dallime ekzistojnë edhe ndërmjet qarqeve.

Në arsimin e mesëm publik raporti i mësueve për nxënës është i ndryshëm për qarqe të ndryshme. Në vitin e fundit raportin më të lartë e mbajnë përkatësisht qarqet Durrës, Kukës, Tiranë; kjo renditje ndryshon kur krahasojmë raportin për qytet ose fshat. Kështu raporti është më i lartë përkatësisht për qytetet e qarqeve Kukës, Durrës, Dibër dhe për fshatrat e qarqeve Durrës, Tiranë e Shkodër. Ndonëse ky raport është shumë më i ulët në arsimin privat gjithashtu edhe këtu ekzistojnë dallime ndërmjet qarqeve.

Në arsimin 9 vjeçar marrin pjesë afërsisht në të gjitha vitet 52-53 % djem përkundrejt 47- 48 % vajza. Në vlera absolute ka ardhur duke u ulur në mënyrë të vazhdueshme numri i nxënësve në 9 vjeçare sikurse edhe lindshmëria. Vihet re se të regjistruarit në qytete janë lehtësisht më të shumtë se në fshat, por kur krahasimi bëhet me qarqe ka diferenca akoma më të theksuara. Kjo ndodh sidomos me Tiranën (rreth 72 %) e Vlorën (rreth 65- 66 %) që mbajnë vendin e parë për regjistrimet e qytetit, por edhe me Dibrën e Kukësin për regjistrimet e fshatit. Tirana dhe Durrësi janë qarqet me raportin më të lartë mësues për nxënës në fillore publik dhe akoma më të lartë e kanë në qytetet përkatëse. Përkundrazi vlerat më të ulta i mban Gjirokastra sidomos në fshat.

Fig. 2 Nxënës për një mësues në arsimin e mesëm publik dhe privat, 2013-2014



*) Në Qarqet Dibër dhe Kukës nuk ka shkolla të mesme private

Tab. 1 Shkolla 9 vjeçare

Qarqet	2009-2010		2010-2011		2011-2012		2012-2013		2013-2014	
	Gjithsej	Qytet	Gjithsej	Qytet	Gjithsej	Qytet	Gjithsej	Qytet	Gjithsej	Qytet
Shqipëria	1.600	452	1.496	445	1.473	435	1.472	434	1.464	434
Berat	103	26	97	25	94	25	94	25	94	25
Dibër	97	13	98	12	98	12	97	12	97	11
Durrës	113	45	107	46	105	43	105	43	105	43
Elbasan	219	36	213	34	197	34	198	34	198	35
Fier	176	46	170	47	172	46	171	45	169	44
Gjirokastrë	61	15	48	14	47	14	47	14	46	13
Korçë	131	28	127	27	127	27	125	25	125	26
Kukës	105	9	83	10	82	9	82	9	83	10
Lezhë	84	23	76	22	77	21	79	23	80	23
Shkodër	147	36	136	37	136	37	138	38	137	40
Tiranë	248	136	238	132	239	127	235	126	230	123
Vlorë	116	39	103	39	99	40	101	40	100	41

Tab. 2 Mësues në shkollat 9 vjeçare

Qarqet	2009-2010		2010-2011		2011-2012		2012-2013		2013-2014	
	Gjithsej	Qytet	Gjithsej	Qytet	Gjithsej	Qytet	Gjithsej	Qytet	Gjithsej	Qytet
Shqipëria	27.241	11.965	25.973	11.544	25.584	11.291	25.263	11.146	25.051	11.069
Berat	1.464	610	1.424	574	1.388	553	1.317	501	1.343	534
Dibër	1.750	410	1.581	358	1.556	361	1.528	353	1.510	341
Durrës	2.267	1.207	2.171	1.188	2.119	1.125	2.084	1.108	2.031	1.091
Elbasan	3.221	980	3.071	960	2.991	906	2.979	924	2.984	941
Fier	3.196	1.056	3.008	1.045	2.984	1.026	2.979	1.038	2.924	994
Gjirokastrë	911	405	897	394	860	373	867	385	863	392
Korçë	2.015	657	2.118	707	2.042	709	2.000	675	1.977	675
Kukës	1.252	309	1.132	294	1.115	281	1.104	279	1.115	289
Lezhë	1.476	547	1.335	520	1.289	509	1.271	506	1.241	488
Shkodër	2.463	1.049	2.321	1.003	2.278	979	2.296	991	2.266	967
Tiranë	5.474	3.736	5.273	3.558	5.329	3.532	5.257	3.476	5.219	3.450
Vlorë	1.752	999	1.642	943	1.633	937	1.581	910	1.578	907

Tab. 3 Nxënës të regjistruar në arsimin 9 vjeçar

Qarqet	2009-2010		2010-2011		2011-2012		2012-2013		2013-2014	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Shqipëria	439.995	211.142	420.684	201.046	403.704	192.146	390.837	185.387	377.074	178.604
Berat	21.703	10.529	20.382	9.839	19.466	9.379	18.740	9.002	18.000	8.639
Dibër	26.830	12.908	25.166	12.054	23.725	11.232	22.405	10.529	21.200	9.897
Durrës	43.357	20.771	41.811	19.936	40.372	19.240	39.568	18.774	38.247	18.059
Elbasan	48.066	23.219	45.138	21.767	42.841	20.534	41.341	19.670	39.022	18.678
Fier	48.519	23.188	45.985	21.928	43.837	20.755	42.096	19.918	40.512	19.124
Gjirokastrë	9.685	4.692	9.121	4.369	8.656	4.177	8.330	3.957	8.112	3.877
Korçë	30.251	14.570	28.717	13.775	27.387	13.065	26.794	12.779	25.897	12.282
Kukës	18.584	8.807	17.621	8.311	16.736	7.798	15.811	7.331	14.948	6.862
Lezhë	23.623	11.424	22.461	10.738	21.178	10.018	20.136	9.457	19.296	9.005
Shkodër	37.008	17.650	35.086	16.724	33.198	15.798	31.375	14.948	29.578	14.067
Tiranë	107.226	51.377	104.866	50.085	102.673	48.998	101.255	48.136	99.902	47.468
Vlorë	25.143	12.007	24.330	11.520	23.635	11.152	22.986	10.886	22.360	10.646

Tab. 4 Nxënës të regjistruar në arsimin 9 vjeçar, cikli i ulët

Qarqet	2009-2010		2010-2011		2011-2012		2012-2013		2013-2014	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Shqipëria	224.781	106.917	215.660	102.276	206.617	97.583	198.897	93.774	195.720	92.609
Berat	10.961	5.273	10.300	4.930	9.733	4.661	9.373	4.471	9.193	4.414
Dibër	13.939	6.631	13.126	6.200	12.116	5.615	11.096	5.081	10.564	4.795
Durrës	22.535	10.703	21.800	10.319	20.953	9.869	20.463	9.626	20.174	9.502
Elbasan	23.895	11.381	22.454	10.693	21.234	10.155	20.239	9.626	19.840	9.528
Fier	24.165	11.479	23.008	10.879	22.153	10.408	21.311	9.964	21.064	9.881
Gjirokastrë	4.736	2.336	4.498	2.154	4.298	2.084	4.172	1.983	4.247	2.037
Korçë	15.318	7.337	14.593	6.971	13.813	6.511	13.500	6.437	13.418	6.366
Kukës	9.752	4.574	9.160	4.279	8.594	3.949	8.020	3.677	7.486	3.400
Lezhë	12.012	5.632	11.463	5.360	10.698	4.911	10.008	4.594	9.686	4.509
Shkodër	18.853	8.930	17.682	8.406	16.624	7.905	15.469	7.365	14.619	6.986
Tiranë	55.842	26.571	55.215	26.271	54.255	25.848	53.285	25.346	53.533	25.516
Vlorë	12.773	6.070	12.361	5.814	12.146	5.667	11.961	5.604	11.896	5.675

Tab. 5 Nxënës të regjistruar në arsimin 9 vjeçar publik

Qarqet	2009-2010		2010-2011		2011-2012		2012-2013		2013-2014	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Shqipëria	418.754	201.332	399.504	191.158	382.870	182.452	370.238	175.682	356.347	168.842
Berat	21.164	10.306	19.881	9.636	18.945	9.168	18.231	8.793	17.498	8.416
Dibër	26.765	12.890	25.142	12.048	23.719	11.230	22.405	10.529	21.200	9.897
Durrës	41.202	19.741	39.597	18.902	38.065	18.162	37.188	17.674	35.768	16.895
Elbasan	47.517	22.918	44.636	21.516	42.428	20.319	40.946	19.471	38.616	18.470
Fier	45.459	21.879	43.156	20.671	41.171	19.586	39.629	18.797	38.060	18.035
Gjirokastrë	9.443	4.577	8.948	4.286	8.432	4.068	8.044	3.813	7.743	3.691
Korçë	29.128	14.049	27.515	13.218	26.199	12.524	25.629	12.227	24.895	11.815
Kukës	18.528	8.791	17.564	8.293	16.736	7.798	15.811	7.331	14.948	6.862
Lezhë	22.811	11.067	21.500	10.305	20.162	9.557	19.095	8.978	18.214	8.498
Shkodër	33.596	16.072	31.645	15.057	29.911	14.214	28.144	13.344	26.400	12.514
Tiranë	99.987	47.943	97.594	46.635	95.376	45.577	93.969	44.696	92.436	43.953
Vlorë	23.154	11.099	22.326	10.591	21.726	10.249	21.147	10.029	20.569	9.796

Tab. 6 Nxënës të regjistruar në arsimin 9 vjeçar publik , cikli i ulët

Qarqet	2009-2010		2010-2011		2011-2012		2012-2013		2013-2014	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Shqipëria	213.109	101.606	204.027	97.009	195.279	92.492	187.860	88.670	184.410	87.393
Berat	10.624	5.133	9.976	4.804	9.389	4.522	9.027	4.327	8.843	4.253
Dibër	13.895	6.617	13.109	6.195	12.110	5.613	11.096	5.081	10.564	4.795
Durrës	21.244	10.103	20.485	9.720	19.613	9.259	19.110	9.000	18.746	8.842
Elbasan	23.603	11.219	22.189	10.561	21.017	10.046	20.029	9.519	19.612	9.415
Fier	22.777	10.900	21.702	10.309	20.898	9.872	20.161	9.453	19.876	9.387
Gjirokastrë	4.535	2.237	4.325	2.071	4.088	1.984	3.920	1.858	3.948	1.888
Korçë	14.577	6.978	13.835	6.628	13.114	6.205	12.855	6.124	12.878	6.117
Kukës	9.719	4.564	9.134	4.269	8.594	3.949	8.020	3.677	7.486	3.400
Lezhë	11.415	5.366	10.782	5.053	9.992	4.588	9.307	4.264	8.982	4.178
Shkodër	17.191	8.185	16.116	7.699	15.198	7.270	14.122	6.731	13.245	6.345
Tiranë	51.858	24.731	51.135	24.395	50.166	23.991	49.260	23.479	49.318	23.542
Vlorë	11.671	5.573	11.239	5.305	11.100	5.193	10.953	5.157	10.912	5.231

Tab. 7 Nxënës të diplomuar në arsimin 9 vjeçar

Qarqet	2009-2010		2010-2011		2011-2012		2012-2013		2013-2014	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Shqipëria	52.287	25.834	51.186	25.155	50.380	24.579	47.819	23.164	44.139	21.294
Berat	2.723	1.406	2.573	1.238	2.523	1.223	2.372	1.144	2.288	1.145
Dibër	3.161	1.490	3.015	1.475	2.850	1.399	2.624	1.256	2.528	1.206
Durrës	4.790	2.240	4.826	2.360	4.634	2.286	4.632	2.278	4.461	2.151
Elbasan	5.831	2.959	5.511	2.822	5.414	2.690	5.544	2.698	4.906	2.406
Fier	5.989	2.969	5.890	2.894	5.861	2.773	5.274	2.545	4.856	2.292
Gjirokastrë	1.189	553	1.258	608	1.224	594	1.061	462	969	486
Korçë	3.674	1.828	3.654	1.825	3.421	1.649	3.276	1.577	2.468	1.200
Kukës	2.015	937	1.939	920	2.083	993	1.850	891	1.825	862
Lezhë	2.974	1.541	2.799	1.406	2.700	1.336	2.491	1.260	2.358	1.142
Shkodër	4.345	2.146	3.811	1.865	4.216	2.095	4.011	1.972	3.680	1.746
Tiranë	12.647	6.319	12.868	6.225	12.355	6.063	11.790	5.697	11.209	5.378
Vlorë	2.949	1.446	3.042	1.517	3.099	1.478	2.894	1.384	2.591	1.280

Tab. 8 Nxënës të diplomuar në arsimin 9 vjeçar publik

Qarqet	2009-2010		2010-2011		2011-2012		2012-2013		2013-2014	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Shqipëria	49.766	24.604	48.551	23.887	47.853	23.318	45.350	21.913	41.729	20.098
Berat	2.660	1.373	2.518	1.216	2.472	1.200	2.325	1.122	2.255	1.128
Dibër	3.153	1.487	3.008	1.474	2.850	1.399	2.624	1.256	2.528	1.206
Durrës	4.559	2.116	4.608	2.257	4.379	2.153	4.361	2.158	4.153	2.009
Elbasan	5.779	2.928	5.439	2.787	5.357	2.657	5.488	2.669	4.864	2.383
Fier	5.465	2.713	5.360	2.643	5.402	2.568	4.880	2.365	4.509	2.121
Gjirokastrë	1.185	552	1.258	608	1.224	594	1.061	462	969	486
Korçë	3.591	1.795	3.564	1.778	3.338	1.619	3.163	1.519	2.358	1.147
Kukës	2.015	937	1.931	920	2.083	993	1.850	891	1.825	862
Lezhë	2.945	1.525	2.711	1.365	2.646	1.313	2.420	1.226	2.278	1.096
Shkodër	3.927	1.952	3.325	1.618	3.738	1.857	3.506	1.694	3.190	1.486
Tiranë	11.761	5.884	12.033	5.821	11.541	5.625	10.985	5.271	10.407	5.001
Vlorë	2.726	1.342	2.796	1.400	2.823	1.340	2.687	1.280	2.393	1.173

Tab. 9 Shkolla të mesme*

Qarqet	2009-2010		2010-2011		2011-2012		2012-2013		2013-2014	
	Gjithsej	E mesme e përgjithshme	Gjithsej	E mesme e përgjithshme	Gjithsej	E mesme e përgjithshme	Gjithsej	E mesme e përgjithshme	Gjithsej	E mesme e përgjithshme
Shqipëria	500	430	508	445	507	437	511	444	512	447
Berat	28	23	28	24	29	25	28	24	28	24
Dibër	23	22	23	21	23	21	24	22	25	24
Durrës	33	28	34	30	34	28	36	30	36	31
Elbasan	55	48	54	48	54	48	54	49	53	48
Fier	63	56	63	58	62	56	64	59	64	59
Gjirokastrë	21	18	22	19	22	19	22	19	22	19
Korçë	46	38	46	38	46	38	45	37	46	38
Kukës	20	20	21	21	20	20	20	20	19	19
Lezhë	24	21	25	23	25	22	25	22	25	22
Shkodër	46	38	47	38	48	39	49	40	47	38
Tiranë	97	81	103	89	103	85	103	86	103	86
Vlorë	44	37	42	36	41	36	41	36	44	39

*Diferenca ndërmjet shkollave të mesme gjithsej me ato të mesme të përgjithshme është numri i shkollave profesionale

Tab. 10 Shkolla të mesme publike*

Qarqet	2009-2010		2010-2011		2011-2012		2012-2013		2013-2014	
	Gjithsej	E mesme e përgjithshme	Gjithsej	E mesme e përgjithshme	Gjithsej	E mesme e përgjithshme	Gjithsej	E mesme e përgjithshme	Gjithsej	E mesme e përgjithshme
Shqipëria	382	326	384	328	383	327	385	331	386	332
Berat	24	19	24	20	24	20	24	20	24	20
Dibër	22	21	22	20	22	20	23	21	24	23
Durrës	22	18	22	18	22	18	23	19	23	19
Elbasan	49	43	48	42	48	42	48	43	48	43
Fier	41	37	42	38	42	38	43	39	43	39
Gjirokastrë	21	18	21	18	21	18	21	18	21	18
Korçë	40	32	40	32	40	32	40	32	40	32
Kukës	18	18	19	19	19	19	19	19	19	19
Lezhë	21	20	21	20	21	19	21	19	21	19
Shkodër	39	31	39	31	39	31	39	31	37	29
Tiranë	53	42	55	44	55	44	54	44	56	45
Vlorë	32	27	31	26	30	26	30	26	30	26

*Diferenca ndërmjet shkollave të mesme me ato publike është numri i shkollave private

Tab. 11 Mësues në shkollat e mesme

Qarqet	2009-2010		2010-2011		2011-2012		2012-2013		2013-2014	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Shqipëria	8.250	5.080	8.179	5.088	8.473	5.295	8.610	5.476	8.606	5.462
Berat	477	259	458	256	458	257	450	257	460	260
Dibër	329	169	318	173	327	172	343	186	345	184
Durrës	613	389	619	398	666	446	695	455	664	445
Elbasan	850	510	843	496	855	515	854	514	850	520
Fier	1.008	624	929	591	926	581	931	594	934	561
Gjirokastrë	281	144	278	137	301	160	250	129	285	150
Korçë	661	364	666	373	672	371	679	381	666	380
Kukës	222	121	227	119	238	127	254	142	253	150
Lezhë	401	237	383	229	412	260	425	270	445	282
Shkodër	780	471	748	455	799	484	790	476	788	489
Tiranë	2.038	1.423	2.143	1.502	2.246	1.568	2.364	1.710	2.310	1.666
Vlorë	590	369	567	359	573	354	575	362	606	375

Tab. 12 Mësues në shkollat e mesme publike

Qarqet	2009-2010		2010-2011		2011-2012		2012-2013		2013-2014	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Shqipëria	6.858	4.215	6.702	4.145	6.907	4.316	6.971	4.407	7.107	4.491
Berat	454	248	435	244	434	246	425	248	435	252
Dibër	320	165	311	170	326	172	342	186	345	184
Durrës	480	301	481	310	508	333	524	341	525	342
Elbasan	789	474	785	464	800	486	805	488	806	495
Fier	751	483	694	451	690	436	723	462	735	436
Gjirokastrë	268	144	270	136	293	159	244	128	279	149
Korçë	613	338	591	327	592	326	596	337	601	350
Kukës	220	120	222	117	235	125	251	141	253	150
Lezhë	389	231	374	224	388	243	391	250	393	255
Shkodër	599	351	603	354	603	360	599	359	595	360
Tiranë	1.504	1.063	1.496	1.063	1.595	1.146	1.614	1.170	1.689	1.225
Vlorë	471	297	440	285	443	284	457	297	451	293

Tab. 13 Nxënës të regjistruar në arsimin e mesëm

Qarqet	2009-2010		2010-2011		2011-2012		2012-2013		2013-2014	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Shqipëria	140.657	65.854	150.134	69.388	152.182	70.165	154.425	70.891	151.937	69.301
Berat	8.414	3.698	8.970	3.828	8.570	3.634	8.837	3.684	8.323	3.464
Dibër	6.720	3.276	7.381	3.362	7.497	3.402	7.308	3.501	6.925	3.436
Durrës	11.654	5.567	13.901	6.229	15.153	6.705	15.551	6.841	15.152	6.728
Elbasan	13.768	6.819	14.514	6.827	14.919	6.971	15.246	7.023	15.152	7.019
Fier	15.679	7.387	15.886	7.529	15.579	7.421	15.873	7.412	15.797	7.224
Gjirokastrë	3.638	1.757	4.011	1.822	3.847	1.805	3.765	1.728	3.482	1.622
Korçë	9.957	4.555	10.733	4.873	11.182	5.032	11.403	5.097	11.416	5.038
Kukës	5.372	2.504	6.227	3.021	6.070	2.849	5.901	2.806	5.479	2.558
Lezhë	6.987	3.653	7.555	3.909	7.774	4.009	7.734	3.950	7.590	3.775
Shkodër	11.346	5.216	12.249	5.652	11.929	5.523	12.399	5.662	11.951	5.471
Tiranë	38.602	17.254	39.924	18.062	40.689	18.632	41.243	18.943	40.532	18.594
Vlorë	8.520	4.168	8.783	4.274	8.973	4.182	9.165	4.244	10.138	4.372

Tab. 14 Nxënës të regjistruar në arsimin e mesëm publik

Qarqet	2009-2010		2010-2011		2011-2012		2012-2013		2013-2014	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Shqipëria	128.360	59.596	136.188	62.544	136.329	62.796	137.105	63.033	133.794	60.999
Berat	8.176	3.545	8.775	3.711	8.234	3.497	8.366	3.520	7.816	3.309
Dibër	6.677	3.252	7.196	3.307	7.288	3.351	7.084	3.446	6.717	3.392
Durrës	10.531	4.918	12.128	5.408	12.310	5.619	12.062	5.482	11.568	5.225
Elbasan	13.426	6.716	14.138	6.723	14.563	6.873	14.873	6.923	14.822	6.927
Fier	13.002	6.007	13.138	6.032	12.764	5.907	13.076	5.989	12.881	5.738
Gjirokastrë	3.608	1.732	3.976	1.822	3.816	1.805	3.734	1.728	3.454	1.622
Korçë	9.445	4.259	10.073	4.492	10.429	4.609	10.716	4.708	10.666	4.612
Kukës	5.352	2.495	6.205	3.013	6.046	2.842	5.885	2.801	5.479	2.558
Lezhë	6.864	3.605	7.401	3.826	7.522	3.858	7.309	3.720	7.034	3.515
Shkodër	9.856	4.317	10.577	4.658	10.126	4.443	10.446	4.563	9.945	4.311
Tiranë	34.242	15.273	35.149	15.948	35.737	16.560	35.889	16.682	35.135	16.281
Vlorë	7.181	3.477	7.432	3.604	7.494	3.432	7.665	3.471	8.277	3.509

Tab. 15 Nxënës të regjistruar në gjimnaz

Qarqet	2009-2010		2010-2011		2011-2012		2012-2013		2013-2014	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Shqipëria	120.651	59.662	131.437	64.590	133.002	65.906	130.137	65.594	124.619	63.456
Berat	7.322	3.398	7.978	3.616	7.574	3.464	7.509	3.455	6.912	3.233
Dibër	5.967	2.776	6.643	2.956	6.891	3.119	6.725	3.206	6.459	3.201
Durrës	9.919	5.266	11.952	5.909	13.016	6.355	12.970	6.477	12.478	6.368
Elbasan	11.541	6.167	12.553	6.394	13.042	6.689	12.762	6.601	12.231	6.527
Fier	14.208	6.994	14.631	7.321	14.358	7.308	14.362	7.291	14.142	7.108
Gjirokastrë	3.228	1.612	3.679	1.720	3.498	1.717	3.328	1.630	3.011	1.514
Korçë	8.191	4.060	9.051	4.458	9.406	4.635	8.725	4.474	8.324	4.325
Kukës	5.031	2.278	5.952	2.892	5.880	2.782	5.677	2.724	5.287	2.500
Lezhë	6.271	3.259	6.865	3.556	7.093	3.692	6.811	3.589	6.556	3.428
Shkodër	9.390	4.712	10.425	5.270	10.104	5.138	9.989	5.130	9.422	4.876
Tiranë	32.338	15.302	34.039	16.458	34.449	17.049	33.799	17.050	32.146	16.433
Vlorë	7.245	3.838	7.669	4.040	7.691	3.958	7.480	3.967	7.651	3.943

Tab. 16 Nxënës të regjistruar në gjimnaze publike

Qarqet	2009-2010		2010-2011		2011-2012		2012-2013		2013-2014	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Shqipëria	109.893	53.861	118.842	58.079	118.566	58.886	114.224	57.995	107.948	55.407
Berat	7.084	3.245	7.783	3.499	7.238	3.327	7.038	3.291	6.405	3.078
Dibër	5.924	2.752	6.458	2.901	6.682	3.068	6.501	3.151	6.251	3.157
Durrës	8.821	4.633	10.187	5.093	10.252	5.321	9.519	5.137	8.938	4.890
Elbasan	11.211	6.073	12.186	6.295	12.686	6.591	12.389	6.501	11.901	6.435
Fier	11.673	5.693	11.969	5.868	11.558	5.805	11.573	5.870	11.235	5.622
Gjirokastrë	3.198	1.587	3.644	1.720	3.467	1.717	3.297	1.630	2.983	1.514
Korçë	7.679	3.764	8.391	4.077	8.653	4.212	8.038	4.085	7.574	3.899
Kukës	5.011	2.269	5.930	2.884	5.856	2.775	5.661	2.719	5.287	2.500
Lezhë	6.232	3.238	6.745	3.492	6.856	3.549	6.459	3.364	6.155	3.174
Shkodër	7.975	3.832	8.861	4.303	8.448	4.116	8.211	4.084	7.568	3.764
Tiranë	29.076	13.595	30.304	14.556	30.540	15.163	29.406	14.928	27.693	14.252
Vlorë	6.009	3.180	6.384	3.391	6.330	3.242	6.132	3.235	5.958	3.122

Tab. 17 Nxënës të diplomuar në arsimin e mesëm

Qarqet	2009-2010		2010-2011		2011-2012		2012-2013		2013-2014	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Shqipëria	34.823	18.727	40.354	20.094	40.927	20.801	45.899	22.625	35.254	18.882
Berat	2.043	1.130	2.324	1.122	2.250	1.044	2.676	1.226	1.882	959
Dibër	1.762	968	2.022	1.011	1.954	945	2.228	1.081	1.844	987
Durrës	2.418	1.379	3.274	1.623	3.411	1.877	4.174	2.064	3.367	1.770
Elbasan	3.572	2.090	3.903	2.038	3.970	2.051	4.622	2.321	3.312	1.928
Fier	4.450	2.371	4.556	2.274	4.536	2.313	5.134	2.511	4.126	2.196
Gjirokastrë	1.063	545	1.273	587	1.105	583	1.156	572	690	406
Korçë	2.637	1.321	3.021	1.422	2.879	1.459	3.284	1.600	2.283	1.324
Kukës	1.241	673	1.558	759	1.603	761	1.733	902	1.645	837
Lezhë	1.737	1.005	2.206	1.196	2.180	1.204	2.402	1.321	1.932	1.089
Shkodër	2.545	1.309	3.261	1.620	3.247	1.700	3.612	1.807	3.083	1.579
Tiranë	9.060	4.685	10.612	5.206	11.454	5.645	12.416	5.933	9.520	4.957
Vlorë	2.295	1.251	2.344	1.235	2.338	1.219	2.462	1.287	1.570	850

Tab. 18 Nxënës të diplomuar në arsimin e mesëm publik

Qarqet	2009-2010		2010-2011		2011-2012		2012-2013		2013-2014	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Shqipëria	30.904	16.677	35.821	17.901	35.890	18.372	40.091	20.059	30.297	16.587
Berat	1.937	1.062	2.251	1.080	2.179	997	2.575	1.180	1.779	914
Dibër	1.715	948	1.942	992	1.849	919	2.098	1.052	1.755	960
Durrës	2.120	1.210	2.791	1.387	2.833	1.605	3.167	1.673	2.551	1.399
Elbasan	3.472	2.049	3.782	2.005	3.821	2.015	4.474	2.280	3.192	1.893
Fier	3.452	1.867	3.545	1.764	3.435	1.733	3.940	1.965	2.928	1.628
Gjirokastrë	1.056	545	1.258	587	1.097	583	1.146	572	684	406
Korçë	2.523	1.256	2.870	1.346	2.621	1.315	3.055	1.468	2.045	1.186
Kukës	1.241	673	1.550	756	1.590	757	1.733	902	1.642	837
Lezhë	1.717	995	2.173	1.177	2.164	1.195	2.321	1.266	1.803	1.009
Shkodër	2.147	1.059	2.788	1.327	2.714	1.368	2.999	1.468	2.479	1.222
Tiranë	7.691	4.030	8.963	4.451	9.763	4.902	10.631	5.194	7.931	4.308
Vlorë	1.833	983	1.908	1.029	1.824	983	1.952	1.039	1.508	825

Tab. 19 Nxënës të diplomuar në gjimnaz

Qarqet	2009-2010		2010-2011		2011-2012		2012-2013		2013-2014	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Shqipëria	29.984	16.450	35.553	18.236	38.083	19.924	41.577	21.451	32.118	17.940
Berat	1.785	1.004	2.059	1.027	2.091	1.006	2.417	1.184	1.761	933
Dibër	1.474	753	1.741	798	1.861	911	2.085	989	1.716	907
Durrës	2.143	1.266	2.833	1.530	3.288	1.829	3.686	1.949	3.078	1.731
Elbasan	3.076	1.827	3.387	1.834	3.719	2.003	4.103	2.210	3.149	1.920
Fier	4.099	2.210	4.239	2.158	4.418	2.289	4.906	2.484	3.956	2.176
Gjirokastrë	942	481	1.161	538	1.028	548	1.068	542	649	378
Korçë	2.212	1.154	2.702	1.325	2.656	1.392	2.906	1.491	2.097	1.247
Kukës	1.132	589	1.442	684	1.603	761	1.706	875	1.611	818
Lezhë	1.543	886	2.010	1.062	2.062	1.139	2.277	1.239	1.810	1.008
Shkodër	2.156	1.172	2.855	1.519	2.948	1.625	3.188	1.712	2.677	1.469
Tiranë	7.450	3.979	9.075	4.629	10.260	5.250	10.981	5.525	8.206	4.529
Vlorë	1.972	1.129	2.049	1.131	2.149	1.171	2.254	1.251	1.408	824

Tab. 20 Nxënës të diplomuar në gjimnaze publike

Qarqet	2009-2010		2010-2011		2011-2012		2012-2013		2013-2014	
	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra	Gjithsej	Femra
Shqipëria	26.512	14.590	31.415	16.191	33.324	17.569	36.059	18.929	27.422	15.694
Berat	1.679	936	1.986	985	2.020	959	2.316	1.138	1.658	888
Dibër	1.427	733	1.661	779	1.756	885	1.955	960	1.627	880
Durrës	1.860	1.107	2.358	1.299	2.710	1.557	2.679	1.558	2.262	1.360
Elbasan	2.983	1.792	3.276	1.805	3.570	1.967	3.955	2.169	3.029	1.885
Fier	3.171	1.741	3.279	1.673	3.328	1.719	3.717	1.941	2.758	1.608
Gjirokastrë	935	481	1.146	538	1.020	548	1.058	542	643	378
Korçë	2.098	1.089	2.551	1.249	2.398	1.248	2.677	1.359	1.859	1.109
Kukës	1.132	589	1.434	681	1.590	757	1.706	875	1.608	818
Lezhë	1.536	880	1.996	1.054	2.062	1.139	2.196	1.184	1.681	928
Shkodër	1.758	922	2.382	1.226	2.415	1.293	2.611	1.381	2.099	1.121
Tiranë	6.401	3.441	7.725	3.971	8.820	4.562	9.436	4.819	6.818	3.911
Vlorë	1.532	879	1.621	931	1.635	935	1.753	1.003	1.380	808

TREGU I PUNËS

Hyrje

Statistikat e tregut të punës sigurojnë përshkrime të strukturës së tregut të punës bazuar në informacionin e të dhënave administrative dhe vlerësime të anketës së forcave të punës. Qëllimi kryesor i prodhimit të statistikave të tregut të punës është marrja e informacionit sa më të plotë mbi tregun e punës dhe dinamikën e tij, si dhe vënia e statistikave të duhura në dispozicion të politikë-bërësve për hartimin e politikave të tregut të punës.

Të dhënat për punësimin dhe papunësinë që publikohen nga INSTAT me periodicitet tremujor dhe vjetor bazohen në

dy burime të veçanta:

1- Burimet administrative, të cilat sigurojnë të dhëna për: (a) numrin e të punësuarve në ndërmarrjet të cilat deklarojnë tatimet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve; (b) punësimin në sektorin shtetëror; (c) papunësinë e regjistruar. 2- Anketa e Forcave të Punës (AFP), e cila është një vërtetim statistikor që kryhet pranë familjeve dhe siguron informacion gjithëpërfshirës mbi situatën e tregut të punës në nivel kombëtar. Në vitet 2007 deri 2011 Anketa e Forcave të Punës është kryer çdo vit, ndërsa nga viti 2012 AFP është kryer si anketë e vazhduar.

Të dhënat administrative sipas qarqeve

Të dhënat administrative sipas qarqeve të përfshira në këtë kapitull, përfshijnë informacion mbi treguesit e tregut të punës bazuar në të dhënat administrative për punësimin dhe papunësinë në Shqipëri.

Të dhënat administrative mbi punësimin sipas qarqeve përmbajnë të dhëna mbi punësimin në sektorin privat jo-bujqësor, punësimin dhe pagat në sektorin shtetëror si dhe punësimin në administratën publike lokale.

Të dhënat administrative mbi papunësinë e regjistruar sipas qarqeve përmbajnë të dhëna mbi punëkërkesit e papunë të regjistruar, me një detajim të veçantë të të rinjve 15-24 vjeç, femrave dhe nivelit arsimor; punëkërkesit e papunë të regjistruar afatgjatë dhe punëkërkesit e papunë në pagesë papunësie.

Të dhënat administrative mbi ndihmën ekonomike sipas qarqeve përmbajnë të dhëna mbi numrin e familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike dhe fondin mesatar mujor të shpërndarë për familjet në ndihmë ekonomike.

Për punësimin në sektorin shtetëror të dhënat bazohen në informacionin e grumbulluar nga INSTAT në përputhje me Programin e Statistikave Zyrtare 2012-2016. Punësimi

në sektorin publik përbëhet nga qeveria qendrore, pushteti vendor dhe ndërmarrjet publike.

Për punësimin në sektorin privat jo-bujqësor burimi është informacioni i mbledhur nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit, i cili i merr të dhënat nga Zyrtarët e Punësimit dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Për punësimin në sektorin privat bujqësor në Shqipëri nuk ka burim administrativ. Për këtë arsye burimi kryesor i përdorur për matjen e punësimit në këtë sektor janë anketat e kryera pranë familjeve. Nga viti 2007 e në vijim punësimi në sektorin e bujqësisë është vlerësuar nga Anketa e Forcave të Punës.


Të dhënat për **papunësinë e regjistruar** mbështeten në informacionin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Regjistrimi i të papunëve në zyrtarët e punësimit bëhet në bazë të VKM Nr. 70, datë 11.02.1999 "Për evidentimin e punëkërkesve të papunë". Të dhënat për **ndihmën ekonomike** bazohen në informacionin e Shërbimit Social Shtetëror.

Gjetjet kryesore

Punësimi në sektorin shtetëror, i matur sipas burimeve administrative, nga viti 2010 në vitin 2014 ka rënë me 1 %. E kundërta vihet re për punësimin në sektorin privat jo-bujqësor, ku tendenca përgjatë viteve 2010-2014 është në rritje.

Gjatë 2013-2014, në qarkun e Kukësit pati një rënie prej 2 % të të punësuarve në sektorin privat jo-bujqësor. Në qarqet e tjera ka një rritje që ndryshon nga 1 % në qarqet e Elbasanit dhe Shkodrës, në 27 % në qarkun e Dibrës.


Fig. 1: Ndryshimi në përqindje i punësimit në sektorin privat jo-bujqësor 2013-2014



Nga viti 2010 në vitin 2014 numri i punëkërkuessve të papunë të regjistruar në zyrat e punësimit ka rënë me 1,3 %. Në përgjithësi, për të gjitha qarqet, përqindja që zënë femrat në numrin gjithsej të punëkërkuessve të papunë të regjistruar është 51 %. Përqindja që zënë femrat ndaj punëkërkuessve të papunë të regjistruar gjithsej është më e ulët në qarkun e Dibrës (mesatarisht 45 %), dhe më e lartë në qarqet e Tiranës dhe Vlorës (mesatarisht 56 %).

Të rinjtë e moshës 15-24 vjeç, në periudhën 2012-2014 përbëjnë 16 % të punëkërkuessve të papunë të regjistruar gjithsej. Përqindja që zënë të rinjtë në numrin gjithsej të punëkërkuessve të papunë të regjistruar është pak a shumë e njëjtë në secilin qark. Në qarkun e Shkodrës përqindja e të rinjve ndaj numrit të punëkërkuessve të papunë të regjistruar gjithsej ka një tendencë në rënie, nga 22 % gjatë viteve 2010-2011 në 13 % në vitin 2014.


Fig. 2: Përqindja e të rinjve të moshës 15-24 vjeç ndaj punëkërkesve të papunë të regjistruar për vitet 2010 dhe 2014



Në periudhën 2010-2014, mesatarisht 55 % e punëkërkesve të papunë të regjistruar janë me arsim fillor (deri në 8/9 vjeçar), 29 % janë me arsim të mesëm të përgjithshëm, 12 % janë me arsim të mesëm profesional dhe 4 % janë me arsim të lartë. Gjatë vitit 2014, në qarkun e Lezhës punëkërkesit e papunë të regjistruar me arsim fillor përbëjnë 59 % të

të papunëve. Në qarkun e Vlorës 10 % e punëkërkesve të papunë të regjistruar janë me arsim të lartë. Përqindja e punëkërkesve të papunë me arsim të mesëm të përgjithshëm është më e lartë se për qindja për personat me arsim të mesëm profesional në të gjitha qarqet.

Fig. 3: Shpërndarja e punëkërkuësve të papunë të regjistruar sipas nivelit arsimor, 2014



Mesatarisht në rang vendi, gjatë viteve 2010-2014, 61 % e punëkërkuësve të papunë të regjistruar janë afatgjatë (prej 12 muajsh e më shumë). Pesa që zënë punëkërkuësit e papunë afatgjatë në qarkun e Kukësit është më e ulët sesa në qarqet e tjera (mesatarisht 28 %), dhe është më e lartë në qarqet Fier, Gjirokastër dhe Shkodër (mesatarisht 72 %).

Përkufizime

Të punësuar janë personat në moshë pune që kanë një punë si të punësuar me pagë ose si të vetëpunësuar të cilët janë të deklaruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Punëkërkuësi i papunë konsiderohet dhe **regjistrohet** si i tillë nga zyra përkatëse e punësimit, kur është i papunë, kërkon punë dhe është i gatshëm të paraqitet sa herë që i kërkohet një gjë e tillë. Të tillë konsiderohen edhe personat të cilët janë në marrëdhënie pune ose të vetëpunësuar, por që kërkojnë një punë të re. Punëkërkuësi është një person, i cili jeton në Shqipëri, është mbi 16 vjeç, paraqitet personalisht në Zyrën e Punësimit për të gjetur punë dhe është i aftë për punë.

Punëkërkuës të papunë të regjistruar në pagesë papunësie janë personat e regjistruar si të papunë të cilët trajtohen me të ardhura gjatë periudhës së parë

të papunësisë, mbështetur në programin e trajtimit me pagesë papunësie. Programi bazohet në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Mbi Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë".

Paga mesatare mujore në sektorin shtetëror është paga bruto që merr një i punësuar në këtë sektor për punën që ka kryer. Ajo përbëhet nga: paga bazë për punën e kryer, shtesa mbi pagë për funksione drejtuese, shtesa mbi pagë për vjetërsi në punë dhe shtesa të tjera të rregullta (tituj, grada etj.). Në pagën mesatare mujore bruto nuk zbriten kontributet personale dhe tatimi mbi të ardhurat.

Ndihma ekonomike është një ndihmë në para për familjet e varfra dhe shpërndahet çdo muaj. Ajo mund të jetë e pjesshme ose e plotë, në varësi të të ardhurave të familjes.

Tab. 1 Të punësuar në administratën publike

Qarqet	2010	2011	2012	2013	2014
Shqipëria	166.337	165.100	164.400	163.900	163.885
Berat	8.527	8.409	8.413	8.347	8.295
Dibër	9.301	8.772	8.974	8.992	8.835
Durrës	12.915	12.995	12.473	11.754	11.700
Elbasan	13.521	14.035	13.783	13.703	13.599
Fier	14.285	13.658	14.561	13.636	13.596
Gjirokastrë	6.283	5.939	5.802	5.801	5.721
Korçë	10.501	10.113	9.773	9.823	9.682
Kukës	5.869	5.736	5.295	5.264	5.102
Lezhë	6.823	6.578	6.679	6.764	6.683
Shkodër	11.989	11.505	11.547	11.553	11.213
Tiranë	55.676	57.052	57.070	58.079	59.444
Vlorë	10.647	10.308	10.029	10.184	10.015

Burimi i informacionit: Të dhëna administrative

Tab. 2 Të punësuar në sektorin privat jo-bujqësor

Qarqet	2010	2011	2012	2013	2014
Shqipëria	241.836	256.287	268.690	290.763	318.571
Berat	6.699	6.853	7.827	8.275	8.828
Dibër	4.305	3.578	3.634	3.293	4.190
Durrës	23.166	31.414	33.680	36.825	38.000
Elbasan	13.426	13.399	13.685	13.845	13.990
Fier	16.754	16.092	16.159	16.424	17.671
Gjirokastrë	5.715	6.315	3.500	4.030	4.936
Korçë	12.351	12.422	12.790	12.650	12.685
Kukës	1.828	2.095	1.968	2.076	2.040
Lezhë	7.906	8.078	8.515	8.541	9.256
Shkodër	13.457	13.727	13.665	13.764	13.882
Tiranë	119.428	124.389	135.341	153.014	173.360
Vlorë	16.801	17.924	17.928	18.024	19.732

Burimi i informacionit: Shërbimi Kombëtar i Punësimit

Tab. 3 Të punësuar në sektorin privat bujqësor

Qarqet	2010	2011	2012	2013	2014
Shqipëria	491.361	526.412	526.260	462.253	442.883
Berat	41.202	40.424	42.022	33.957	30.670
Dibër	37.376	39.410	38.114	42.462	34.344
Durrës	27.776	25.017	17.540	11.847	32.820
Elbasan	86.853	78.609	81.568	83.971	89.489
Fier	92.609	80.191	84.588	81.194	77.373
Gjirokastrë	12.705	13.652	13.900	15.067	14.892
Korçë	63.446	58.164	61.435	46.664	39.838
Kukës	12.998	21.864	20.335	17.065	21.738
Lezhë	27.846	36.682	35.599	24.592	17.440
Shkodër	36.103	38.498	37.378	38.962	38.229
Tiranë	37.571	62.903	63.413	44.090	24.040
Vlorë	14.876	30.999	30.369	22.383	22.009

Burimi i informacionit: Vlerësime nga Anketa e Forcave të Punës 2010-2014

Tab. 4 Të punësuar në administratën publike lokale

Qarqet	2010	2011	2012	2013	2014
Shqipëria	13.785	13.941	14.684	14.988	15.065
Berat	995	964	968	966	967
Dibër	645	704	678	682	688
Durrës	985	1.025	1.042	1.027	998
Elbasan	1.448	1.454	1.498	1.498	1.498
Fier	1.597	1.548	1.660	1.745	1.691
Gjirokastrë	679	709	709	717	679
Korçë	1.178	1.190	1.217	1.212	1.202
Kukës	831	828	897	897	897
Lezhë	775	777	873	873	873
Shkodër	1.157	1.154	1.191	1.191	1.191
Tiranë	2.676	2.770	2.741	2.970	3.163
Vlorë	819	818	1.210	1.210	1.218

Burimi i informacionit: Të dhëna administrative

Tab. 5 Të punësuar në administratën publike lokale, komunë

Qarqet	2010	2011	2012	2013	2014
Shqipëria	6.815	6.844	7.250	7.302	7.276
Berat	515	471	480	486	487
Dibër	415	441	417	418	423
Durrës	352	344	374	365	377
Elbasan	766	765	779	779	779
Fier	932	903	950	1.047	1.024
Gjirokastër	409	395	402	410	408
Korçë	703	687	727	727	712
Kukës	349	349	357	357	357
Lezhë	327	329	345	345	345
Shkodër	695	692	732	732	732
Tiranë	1.033	1.146	1.123	1.072	1.062
Vlorë	319	322	564	564	570

Burimi i informacionit: Të dhëna administrative

Tab. 6 Të punësuar në administratën publike lokale, bashki

Qarqet	2010	2011	2012	2013	2014
Shqipëria	5.542	5.583	5.890	6.144	6.281
Berat	348	357	348	340	340
Dibër	160	176	174	177	178
Durrës	536	584	582	574	545
Elbasan	570	577	607	607	607
Fier	563	538	601	590	559
Gjirokastër	190	192	185	185	190
Korçë	387	415	402	397	402
Kukës	365	362	368	368	368
Lezhë	320	320	403	403	403
Shkodër	321	321	320	320	320
Tiranë	1.449	1.412	1.406	1.689	1.867
Vlorë	333	329	494	494	502

Burimi i informacionit: Të dhëna administrative

Tab. 7 Të punësuar në administratën publike lokale, qark

Qarqet	2010	2011	2012	2013	2014
Shqipëria	1.428	1.514	1.544	1.542	1.508
Berat	132	136	140	140	140
Dibër	70	87	87	87	87
Durrës	97	97	86	88	76
Elbasan	112	112	112	112	112
Fier	102	107	109	108	108
Gjirokastrë	80	122	122	122	81
Korçë	88	88	88	88	88
Kukës	117	117	172	172	172
Lezhë	128	128	125	125	125
Shkodër	141	141	139	139	139
Vlorë	167	167	152	152	146

Burimi i informacionit: Të dhëna administrative

Tab. 8 Punëkërkues të papunë të regjistruar, 2014

Qarqet	Gjithsej	Femra	Të rinj 15-24	Niveli arsimor			
				Fillor	E mesme e përgjithshme	E mesme profesionale	I lartë
Shqipëria	141.998	72.467	22.282	76.929	39.299	17.627	8.143
Berat	6.140	3.049	605	3.290	1.433	1.231	186
Dibër	6.004	2.718	1.313	3.500	1.386	770	348
Durrës	9.734	4.650	1.590	5.386	2.590	1.021	737
Elbasan	16.308	7.774	2.797	9.032	5.263	1.773	241
Fier	16.755	9.485	2.767	8.445	3.678	3.337	1.296
Gjirokastrë	4.820	2.395	638	2.367	1.603	408	441
Korçë	9.929	5.144	1.104	5.583	2.548	1.204	594
Kukës	10.727	5.353	2.056	5.252	3.740	1.397	338
Lezhë	13.978	6.921	2.136	8.266	4.193	923	597
Shkodër	16.449	7.719	2.089	8.004	5.537	2.120	788
Tiranë	21.675	12.229	3.514	12.589	4.769	2.724	1.594
Vlorë	9.479	5.029	1.673	5.216	2.560	720	983

Burimi i informacionit: Shërbimi Kombëtar i Punësimit

Tab. 9 Punëkërkues të papunë të regjistruar, 2013

Qarqet	Gjithsej	Femra	Të rinj 15-24	Niveli arsimor			
				Fillor	E mesme e përgjithshme	E mesme profesionale	I lartë
Shqipëria	142.648	73.696	22.318	77.759	41.243	17.690	5.956
Berat	6.492	3.425	694	3.557	1.494	1.294	147
Dibër	6.416	2.959	1.330	3.872	1.539	814	192
Durrës	9.001	4.665	1.236	5.230	2.420	987	365
Elbasan	16.288	7.780	2.744	8.882	5.244	1.980	182
Fier	16.490	9.309	2.845	8.408	3.660	3.302	1.120
Gjirokastrë	5.036	2.725	628	2.369	1.867	394	405
Korçë	9.911	5.224	1.080	5.726	2.583	1.136	466
Kukës	11.210	5.530	2.175	5.425	4.085	1.431	269
Lezhë	15.317	7.612	2.434	9.151	4.622	927	618
Shkodër	18.901	8.910	2.799	8.103	7.603	2.570	625
Tiranë	20.508	11.578	3.192	12.481	4.443	2.507	1.076
Vlorë	7.078	3.978	1.162	4.556	1.684	347	491

Burimi i informacionit: Shërbimi Kombëtar i Punësimit

Tab. 10 Punëkërkues të papunë të regjistruar, 2012

Qarqet	Gjithsej	Femra	Të rinj 15-24	Niveli arsimor			
				Fillor	E mesme e përgjithshme	E mesme profesionale	I lartë
Shqipëria	142.530	73.290	22.129	77.870	41.145	17.879	5.635
Berat	6.694	3.530	726	3.544	1.630	1.351	170
Dibër	6.956	3.184	1.321	4.199	1.664	906	187
Durrës	8.876	4.722	1.318	5.072	2.363	1.014	428
Elbasan	16.174	7.726	2.663	8.741	5.203	2.012	218
Fier	16.124	8.767	2.584	8.173	3.765	3.205	981
Gjirokastrë	5.068	2.833	596	2.357	1.916	370	425
Korçë	9.260	4.922	1.013	5.352	2.446	1.026	436
Kukës	10.018	4.872	1.861	4.930	3.714	1.298	76
Lezhë	14.699	7.308	2.294	8.921	4.367	846	565
Shkodër	19.893	9.171	3.615	8.457	7.973	2.731	733
Tiranë	21.819	12.369	3.082	13.097	4.839	2.805	1.079
Vlorë	6.950	3.885	1.055	5.027	1.269	317	337

Burimi i informacionit: Shërbimi Kombëtar i Punësimit

Tab. 11 Punëkërkues të papunë të regjistruar, 2011

Qarqet	Gjithsej	Femra	Të rinj 15-24	Niveli arsimor			
				Fillor	E mesme e përgjithshme	E mesme profesionale	I lartë
Shqipëria	142.484	72.943	23.569	77.750	41.459	18.100	5.176
Berat	6.504	3.386	711	3.540	1.528	1.311	125
Dibër	7.319	3.456	1.412	4.416	1.864	930	109
Durrës	8.899	4.916	1.204	5.066	2.371	1.003	458
Elbasan	16.209	7.756	2.800	8.754	5.154	2.075	226
Fier	15.700	8.410	2.574	8.061	3.861	2.975	802
Gjirokastrë	5.326	2.832	662	2.447	1.994	389	496
Korçë	9.159	4.911	1.010	5.259	2.441	1.007	452
Kukës	9.457	4.570	1.713	4.614	3.561	1.246	37
Lezhë	14.233	6.970	3.107	8.801	4.175	792	465
Shkodër	21.166	9.590	4.551	8.965	8.404	3.004	792
Tiranë	21.732	12.368	2.790	12.908	4.792	3.086	946
Vlorë	6.782	3.779	1.036	4.918	1.312	281	271

Burimi i informacionit: Shërbimi Kombëtar i Punësimit

Tab. 12 Punëkërkues të papunë të regjistruar, 2010

Qarqet	Gjithsej	Femra	Të rinj 15-24	Niveli arsimor			
				Fillor	E mesme e përgjithshme	E mesme profesionale	I lartë
Shqipëria	143.876	72.857	23.835	76.978	42.912	18.897	5.089
Berat	6.557	3.395	772	3.561	1.628	1.237	131
Dibër	7.851	3.544	1.438	4.491	2.431	830	99
Durrës	8.980	4.940	1.150	5.089	2.445	1.013	433
Elbasan	16.382	7.816	3.029	8.942	4.991	2.221	228
Fier	16.258	8.503	2.820	8.269	4.271	2.978	740
Gjirokastrë	5.328	2.924	609	2.424	1.889	527	488
Korçë	9.432	4.612	984	5.263	2.563	1.116	490
Kukës	9.408	4.989	1.707	4.400	3.519	1.451	38
Lezhë	14.104	6.766	3.244	8.699	4.083	879	443
Shkodër	21.211	9.451	4.628	8.900	8.399	3.127	786
Tiranë	21.599	12.151	2.546	12.548	5.014	3.096	941
Vlorë	6.765	3.766	909	4.392	1.681	421	272

Burimi i informacionit: Shërbimi Kombëtar i Punësimit

Tab. 13 Punëkërkues të papunë afatgjatë

Qarqet	2010	2011	2012	2013	2014
Shqipëria	89.269	88.768	86.975	87.276	82.133
Berat	4.213	4.369	4.788	4.696	4.174
Dibër	4.569	4.006	3.403	3.018	2.570
Durrës	3.074	3.096	3.715	4.263	3.872
Elbasan	10.262	9.960	9.882	9.933	9.953
Fier	12.490	11.865	11.288	11.501	11.584
Gjirokastrë	3.848	3.655	3.330	3.241	3.131
Korçë	5.246	5.383	5.594	6.248	6.579
Kukës	2.360	2.607	2.595	2.990	3.472
Lezhë	9.074	9.420	9.798	9.775	8.275
Shkodër	15.812	15.700	14.512	13.807	11.077
Tiranë	14.761	14.986	14.865	14.744	14.754
Vlorë	3.560	3.720	3.206	3.060	2.694

Burimi i informacionit: Shërbimi Kombëtar i Punësimit

Tab. 14 Punëkërkues të papunë afatgjatë, femra

Qarqet	2010	2011	2012	2013	2014
Shqipëria	44.123	44.085	43.261	43.636	41.929
Berat	2.143	2.246	2.440	2.386	2.105
Dibër	1.559	1.396	1.405	1.255	1.017
Durrës	1.660	1.650	1.769	1.687	1.656
Elbasan	4.698	4.598	4.556	4.550	4.568
Fier	6.494	6.231	6.101	6.368	6.381
Gjirokastrë	2.234	2.086	1.843	1.714	1.639
Korçë	2.801	2.882	2.995	3.276	3.436
Kukës	1.184	1.244	1.248	1.426	1.786
Lezhë	4.962	5.183	4.791	4.843	4.157
Shkodër	6.656	6.618	6.241	6.035	5.324
Tiranë	7.896	8.007	8.202	8.472	8.386
Vlorë	1.836	1.943	1.671	1.625	1.476

Burimi i informacionit: Shërbimi Kombëtar i Punësimit

Tab. 15 Punëkërkues të papunë të regjistruar në pagesë papunësie

Qarqet	2010	2011	2012	2013	2014
Shqipëria	9.265	8.537	9.772	7.824	7.395
Berat	260	301	412	223	313
Dibër	563	476	471	355	414
Durrës	701	630	708	530	398
Elbasan	818	846	974	793	785
Fier	294	360	562	315	315
Gjirokastrë	233	220	299	216	200
Korçë	939	757	885	850	625
Kukës	1.153	1.032	982	1.008	764
Lezhë	699	555	474	331	273
Shkodër	1.225	1.133	1.110	962	748
Tiranë	1.957	1.867	2.420	1.942	2.200
Vlorë	423	361	476	299	361

Burimi i informacionit: Shërbimi Kombëtar i Punësimit

Tab. 16 Punëkërkues të papunë të regjistruar në pagesë papunësie, femra

Qarqet	2010	2011	2012	2013	2014
Shqipëria	4.692	4.305	4.794	3.947	3.590
Berat	113	126	183	109	132
Dibër	244	225	215	134	125
Durrës	417	345	357	267	203
Elbasan	382	396	443	357	343
Fier	154	152	195	143	139
Gjirokastrë	154	136	182	117	92
Korçë	577	453	505	457	298
Kukës	402	370	338	409	302
Lezhë	358	291	260	186	151
Shkodër	720	617	465	385	270
Tiranë	1.006	1.061	1.465	1.283	1.418
Vlorë	165	133	186	100	117

Burimi i informacionit: Shërbimi Kombëtar i Punësimit

Tab. 17 Paga mesatare mujore bruto për një të punësuar në sektorin shtetëror

Lekë

Qarqet	2010	2011	2012	2013	2014
Shqipëria	44.376	46.665	50.092	51.250	53.025
Berat	42.376	44.672	46.836	48.855	50.327
Dibër	43.158	45.245	48.612	50.090	52.126
Durrës	44.152	46.611	48.811	50.355	52.513
Elbasan	43.407	45.818	47.925	49.715	50.127
Fier	44.354	46.863	49.921	52.115	52.301
Gjirokastrë	45.038	47.505	49.811	51.773	51.827
Korçë	43.862	46.537	50.250	51.650	51.888
Kukës	47.430	49.946	48.850	50.252	52.293
Lezhë	41.223	44.061	46.153	47.651	49.141
Shkodër	44.761	47.033	49.500	51.544	51.911
Tiranë	48.131	51.515	56.037	59.450	59.966
Vlorë	44.616	47.125	49.500	51.551	52.380

Burimi i informacionit: Të dhëna administrative

Tab. 18 Numri mesatar i familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike

Qarku	2010	2011	2012	2013	2014
Shqipëria	96.867	99.493	98.810	104.398	78.072
Berat	5.340	5.084	4.562	4.527	2.882
Dibër	13.764	14.480	14.317	14.981	13.045
Durrës	1.439	1.438	1.402	1.403	1.116
Elbasan	12.626	13.445	13.616	14.458	10.277
Fier	3.966	4.187	4.190	4.547	3.411
Gjirokastrë	2.154	2.466	2.577	2.898	2.000
Korçë	9.674	10.463	9.417	10.258	8.248
Kukës	11.419	11.674	12.327	12.842	10.611
Lezhë	7.967	7.610	7.159	7.423	5.932
Shkodër	15.585	15.536	15.375	15.401	11.982
Tiranë	11.069	11.274	12.073	13.656	7.055
Vlorë	1.865	1.838	1.796	2.004	1.513

Burimi i informacionit: Shërbimi Social Shtetëror

Tab. 19 Fondi mesatar mujor i ndihmës ekonomike

000 lekë

Qarqet	2010	2011	2012	2013	2014
Shqipëria	334.437	362.579	360.921	387.987	297.447
Berat	17.339	16.889	14.394	14.225	10.270
Dibër	48.067	54.863	51.473	54.851	47.328
Durrës	5.638	5.770	5.315	5.264	5.026
Elbasan	39.509	41.979	43.170	44.962	36.920
Fier	13.825	14.793	15.045	15.865	10.735
Gjirokastrë	8.074	9.556	8.898	9.351	6.555
Korçë	25.930	29.877	28.319	28.398	25.503
Kukës	44.126	46.618	47.786	53.227	43.487
Lezhë	31.378	30.727	28.447	28.266	23.969
Shkodër	57.859	58.317	62.672	61.949	47.638
Tiranë	36.149	45.894	49.172	64.670	34.282
Vlorë	6.544	7.295	6.230	6.960	5.733

Burimi i informacionit: Shërbimi Social Shtetëror

NIVELI I JETESËS

Hyrje

Niveli i Jetesës në Shqipëri matet nëpërmjet Anketës së Matjes së Nivelit të Jetesës (AMNJ), e cila është një anketë me shumësi qëllimesh e kryer pranë familjeve dhe përbën një nga burimet kryesore të informacionit për të matur kushtet e jetesës, situatën e varfërisë duke siguruar një mjet të domosdoshëm në ndihmë të hartuesve të politikave për monitorimin dhe hartimin e programeve sociale.

Objektivi kryesor i AMNJ është mbledhja e informacionit për të mundësuar matjen e mirëqënies së familjeve shqiptare dhe identifikimin e faktorëve që e përcaktojnë atë. Mirëqënia është matur nëpërmjet agregatit të konsumit, duke siguruar informacion mbi nivelin dhe shpërndarjen e varfërisë në vend. AMNJ është gjithashtu një mjet i fuqishëm për vlerësimin dhe përcaktimin e shpenzimeve sociale.

Përshkrim i shkurtër

Varfëria në Shqipëri është e influencuar nga faktorë të ndryshëm dhe gjithashtu ndikon në jetën sociale dhe ekonomike të individëve. Matja e varfërisë dhe monitorimi i saj luan një faktor të rëndësishëm për politikëbërësit dhe targetimin e shtresave në nevojë. Aspekti gjeografik luan një rol thelbësor në përcaktimin e varfërisë. Matja e varfërisë në Shqipëri bëhet me anën e konsumit si matësi më real dhe më i saktë. Gjithashtu janë një sërë faktorësh të tjerë jo monetarë si arsimi shëndetësia, faktorët demografikë, kushtet e banimit dhe aksesit që tregojnë nivelin e jetesës së familjeve shqiptare. Anketa AMNJ jep një informacion të gjerë lidhur me kushtet e banesës, matjen e varfërisë dhe pabarazinë.

Ajo siguron një bazë ndaj së cilës monitorohet progresi në reduktimin e varfërisë dhe arritja e Objektivave të Zhvillimit të Mileniumit (OZHM).

Anketa e parë AMNJ është kryer në vitin 2002 dhe më pas është përsëritur me një periodicitet tre vjetor përkatësisht në 2005 dhe në 2008 dhe për herë të fundit në 2012, një vit pas Censurit të Popullsisë dhe Banesave 2011. Metodologjia e përdorur është e krahasueshme në vite duke siguruar prodhimin e të dhënave në nivel qarku. Të gjitha llogaritjet e bëra, bazuar në vitet 2005, 2008 dhe 2012, kanë si bazë krahasuese vitin 2002. Për këtë arsye të gjitha rezultatet janë deflatuar për t'i sjellë në vlera reale, që do të thotë se janë pastruar nga influenca e ndryshimit të çmimeve në periodat përkatëse.

Në vitin 2012, u rrit edhe numri i familjeve të zgjedhura për të siguruar që të dhënat e kësaj ankete të ishin përfaqësuese në nivel qarku.

Gjetjet kryesore

Bazuar në kufirin absolut të varfërisë prej 4,891 lekë të shpenzimeve për frymë në muaj të llogaritur nga INSTAT dhe duke përdorur të njëjtën mënyrë llogaritjeje, 14,3 % e individëve janë të varfër në 2012. Kukësi pasuar nga Lezha përbën qarkun më të varfër. Vlora dhe Gjirokastra janë ndër qarqet që kanë nivel varfërie më të ulët krahasuar me qarqet e tjera. Lezha dhe Kukësi pasuar nga Shkodra dhe Durrësi janë qarqet që kanë hendekun e varfërisë më të lartë. Pra jo vetëm që kanë përqindjen më të lartë të të varfërve por për këta individë duhet një nivel më i lartë shpenzimesh për të mbërritur tek kufiri i varfërisë. Ashpërsia e varfërisë mat jo vetëm se sa larg janë të varfërit nga kufiri por edhe pabarazinë midis të varfërve. Në vitin 2012, niveli kombëtar i ashpërsisë së varfërisë, vlerësohet të jetë rreth 1 %.


Tab. 1 Treguesit e varfërisë sipas qarqeve (përqindja, hendeku, ashpërsia)

Qarqet	Treguesit e varfërisë			%
	Përqindja	Hendeku	Ashpërsia	
Shqipëria	14,3	3,0	1,0	
Berat	12,3	2,3	0,7	
Dibër	12,7	2,3	0,7	
Durrës	16,5	3,6	1,3	
Elbasan	11,3	2,3	0,7	
Fier	17,1	3,4	1,0	
Gjirokastrë	10,6	2,4	1,0	
Korçë	12,4	2,5	0,7	
Kukës	22,5	3,8	0,9	
Lezhë	18,4	4,7	1,8	
Shkodër	15,5	3,7	1,6	
Tiranë	13,9	2,7	0,8	
Vlorë	11,1	2,4	0,8	

Niveli i varfërisë është më i lartë në familjet që kanë më shumë anëtarë. Qarku i Kukësit, Dibrës dhe Elbasanit janë qarqet me madhësinë më të madhe të familjes. Këto janë edhe qarqet ku për familjet e varfëra shihet dukshëm niveli mbi mesataren e madhësisë së familjes dhe po ashtu të paturit më shumë fëmijë nën varësi, që do të thotë më

shumë shpenzime për plotësimin e nevojave të përditshme dhe shkollimin e tyre dhe më pak forcë punëtore për të sjellë të ardhura në shtëpi. Pra midis numrit të fëmijëve dhe përqindjes së të varfërve që jetojnë në familje të tilla ekziston një korrelacion i lartë.

Fig. 1 Madhësia mesatare e familjeve të varfëra dhe jo të varfëra



Me rritjen e numrit të fëmijëve rritet edhe përqindja dhe mundësia për të qënë i varfër. Kjo shihet në qarqet Kukës, Lezhë, Dibër dhe Elbasan. Gjirokastra dhe Berati janë qarqet që kanë nivelet më të ulëta të përqindjes së të varfërve

të individëve që jetojnë në familje me tre apo më shumë fëmijë. Kjo ndoshta dhe për faktin që në total këto janë qarqet që kanë përqindjen më të ulët të familjeve që kanë më shumë se tre fëmijë.

Tab. 2 Popullsia në varfëri sipas numrit të fëmijëve që kanë në varësi

Qarqet	Të varfër sipas numrit të fëmijëve				%
	Asnjë fëmijë	Një fëmijë	Dy fëmijë	Tre ose më shumë fëmijë	
Shqipëria	4,5	12,4	15,6	33,1	
Berat	4,6	11,2	16,4	22,8	
Dibër	3,5	4,3	15,1	23,1	
Durrës	1,7	18,0	21,7	33,9	
Elbasan	0,8	3,6	12,1	34,4	
Fier	4,6	16,4	21,6	35,8	
Gjirokastrë	2,2	11,4	16,1	21,0	
Korçë	4,1	9,0	14,8	32,8	
Kukës	10,5	11,4	25,1	37,1	
Lezhë	9,1	16,0	19,7	32,8	
Shkodër	2,9	17,5	15,6	33,8	
Tiranë	5,7	15,0	12,3	35,0	
Vlorë	5,8	1,5	9,2	37,8	

Varfëria nuk është një fenomen vetëm monetar dhe përcaktimi i saj nuk lidhet thjesht me mospasjen e një niveli të nevojshëm shpenzimesh apo konsumi por në aspektin jo-monetar lidhet me moszotërimin apo privimin nga një sërë faktorësh jo-monetarë si të mirat materiale, niveli inevojshëm arsimor, shërbimet bazë, kushte të përshtatshme banimi etj.

Popullsia 21 vjeç e lart ka rreth 10 vite mesatare arsimit të përfunduara. Qarku Tiranë dhe Gjirokastrë kanë ndjeshëm mbi mesataren vitet më të larta të arsimit të përfunduara. Këto janë edhe qarqet që kanë përqindjen më të lartë të individëve që kanë përfunduar arsimin universitar, pasuniversitar/master apo doktoraturë. Niveli arsimor

i individit është një faktor thelbësor që influencon por gjithashtu dhe influencohet nga varfëria. Mund të themi që arsimi është edhe një faktor i trashëguar. Individët që kanë prindërit me një nivel arsimor të lartë kanë më shumë mundësi të arsimohen. Kjo e lidhur edhe me kulturën por gjithashtu e lidhur ngushtë edhe me mundësitë ekonomike. Arsimimi luan një rol thelbësor në gjetjen e një pune të mirë, të mirëpaguar dhe në uljen e riskut për të rënë në varfëri.

Përqindja e individëve të varfër që jetojnë në familje që kanë kryefamiljarin pa arsim apo vetëm me arsimin bazë është më e lartë dhe bie ndjeshëm me rritjen e nivelit arsimor të kryefamiljarit.

Tab. 3 Diploma më e lartë e marrë dhe vitet e arsimit për popullsinë 21 vjeç e lart

Qarqet	Diploma më e lartë e marrë për popullsinë 21 vjeç e lartë						Vitet mesatare të arsimit
	Pa diplomë	Filllore	8 - 9 vjeçare	E mesme	E lartë dhe më lartë	Gjithsej	
Shqipëria	4,0	7,4	40,2	34,1	14,3	100	9,7
Berat	4,8	10,6	49,9	25,6	9,1	100	8,4
Dibër	7,2	7,4	40,4	34,0	10,9	100	9,2
Durrës	3,9	9,3	45,5	31,2	10,1	100	9,3
Elbasan	7,7	9,0	46,0	26,6	10,7	100	8,9
Fier	3,1	7,3	44,7	35,1	9,9	100	9,4
Gjirokastrë	3,1	5,7	41,7	34,6	14,9	100	10,0
Korçë	3,8	9,2	47,3	28,9	10,9	100	9,2
Kukës	4,3	8,5	44,5	31,5	11,2	100	9,2
Lezhë	5,5	11,2	44,4	28,9	10,0	100	8,6
Shkodër	3,7	9,3	41,5	34,0	11,5	100	9,0
Tiranë	2,4	4,5	28,9	41,1	23,0	100	11,0
Vlorë	3,2	5,8	41,6	36,1	13,3	100	9,8

Tab. 4 Përqindja e individëve të varfër sipas arsimit të kryefamiljarit

Qarqet	Arsimi i kryefamiljarit		
	Arsimi bazë	Arsimi i mesëm	Arsimi i lartë dhe nivelet më lart
Shqipëria	18,4	11,7	2,4
Berat	15,0	7,3	-
Dibër	14,3	15,0	-
Durrës	21,7	10,2	7,2
Elbasan	15,1	6,1	1,9
Fier	18,5	19,4	1,8
Gjirokastrë	14,0	8,5	2,6
Korçë	16,7	4,9	-
Kukës	27,6	19,5	6,7
Lezhë	21,7	7,8	12,9
Shkodër	16,2	14,3	2,2
Tiranë	21,5	12,8	1,6
Vlorë	16,0	6,2	-

Në nivel kombëtar, burimi kryesor i ujit është ujë i rrjedhshëm brenda banesës apo brenda ndërtesës (80,6 %). Qarku i Gjirokastrës dhe i Dibrës janë në nivele më të mira krahasuar me nivelin kombëtar por edhe krahasuar me qarqet e tjera.

Në nivele shumë pozitive është edhe treguesi për kushtet higjieno-sanitare ku mbi 94 % e familjeve shqiptare kanë wc në ndërtesë.

Tab. 5 Kushtet e banimit dhe aksesit në shërbimet bazë

Qarqet	Aksesi në shërbimet bazë			Kushtet e banimit
	WC brenda ndërtesës	Ujë të rrjedhshëm brenda ndërtesës	Ngrohje e përshtatshme	Shumë të mira ose të përshtatshme për të jetuar
Shqipëria	94,0	80,6	79,3	93,7
Berat	95,0	77,3	71,0	91,2
Dibër	98,2	90,8	79,6	92,0
Durrës	96,2	71,4	77,2	93,8
Elbasan	88,6	82,5	81,2	91,0
Fier	90,2	80,8	63,2	94,0
Gjirokastrë	88,8	91,4	81,9	91,6
Korçë	88,0	86,9	70,8	89,8
Kukës	84,7	77,6	57,0	87,5
Lezhë	90,5	80,5	88,0	91,3
Shkodër	96,5	73,4	84,8	93,4
Tiranë	98,0	80,2	86,7	97,1
Vlorë	97,9	84,2	87,1	95,5

Individët shqiptarë e shpenzojnë pjesën më të madhe të buxhetit të tyre për konsum ushqimor. Në nivele të ulëta mbetet përqindja që zë zëri i arsimit apo i pajisjeve afatgjata ndaj konsumit total për frymë.

Një aspekt i rëndësishëm për të cilin AMNJ mbledh informacion janë edhe zotërimi i aseteve me afat të gjatë përdorimi. Në tabelën e mëposhtme paraqitet përqindja e familjeve që zotërojnë të paktën një nga pajisjet. Gjirokastra, Korça dhe Tirana janë qarqet që kanë përqindjen më të lartë të familjeve me linjë telefoni fiks. Familjet që kanë përqindjen më të lartë të zotëruesve të telefonave celularë janë në Dibër dhe Elbasan, kjo ndoshta e lidhur edhe me plotësimin

e nevojave për komunikim dhe përdorim të telefonit celular si plotësues i mospasjes së një linje fikse. Zotërimi i televizorit me ngjyra dhe frigoriferit zë një përqindje mjaft të lartë në familjet shqiptare. Përqindja e lartë vihet re në të gjitha qarqet. Zotërimi i makinës qepëse është një mjet i domosdoshëm por që ju vjen dhe në ndihmë familjeve që kanë gra që janë të papuna ose duke plotësuar nevojat shtëpiake. Përqindja më e lartë e zotërimit të makinave qepëse është në Fier (18,8 %). Zotërimi i makinës për larjen e enëve shihet ende si një mjet luksi dhe e futur rishtazi në listën e pajisjeve afatgjata të familjeve shqiptare. Zonat e varfëra si Kukësi dhe Elbasani kanë përqindje të ulët të zotërimit të këtij aseti.

Tab. 6 Zotërimi i pajisjeve afatgjata të familjeve

Qarqet	Pajisje afatgjata							
	Familja ka linjë telefoni fiks	Telefon celular	Televizor me ngjyra	Veturë	Makinë qepëse	Lavatriçe	Frigorifer	Makinë larëse enësh
Shqipëria	24,0	92,4	99,0	17,7	8,1	89,6	97,5	3,2
Berat	23,1	89,5	98,7	19,4	9,2	91,2	97,6	3,6
Dibër	13,6	95,8	99,3	12,0	8,1	76,6	95,7	2,9
Durrës	20,9	92,9	99,0	23,4	3,9	91,2	97,0	3,2
Elbasan	24,5	94,8	99,3	13,5	10,2	83,1	96,6	0,5
Fier	18,3	92,3	99,6	19,1	18,8	89,3	98,9	3,6
Gjirokastrë	36,2	93,9	98,6	21,1	6,2	91,2	99,0	5,1
Korçë	32,2	84,8	99,6	13,9	7,7	84,7	96,4	1,7
Kukës	11,1	93,7	98,0	14,0	8,9	80,1	89,9	0,6
Lezhë	10,9	91,3	98,0	13,3	10,2	81,5	97,0	2,6
Shkodër	22,4	90,9	97,8	14,2	10,1	85,6	96,1	3,8
Tiranë	28,9	93,6	98,9	18,6	4,2	95,5	98,4	3,8
Vlorë	23,9	94,5	99,8	23,3	5,7	97,3	99,4	4,7

Përkufizime

Varfëria Monetare: Për llogaritjen e kufirit të varfërisë monetare është përdorur metodologjia e "Kostos së Nevojave Bazë" (Ravallion dhe Bidani, 1994).

Kufiri i varfërisë është llogaritur duke përdorur shportën ushqimore që konsumohet nga individët që ndodhen në decilen e dytë deri në të katërt. Duke patur parasysh rekomandimet e FAO-s për konsumin minimal të kalorive sipas moshës dhe gjinisë dhe duke i përshtatur këto kërkesa për kalori sipas shpërndarjes së popullsisë në Shqipëri në vitin 2001, marrja e kalorive të nevojshme për frymë u përllogarit në 2.288 kalori në ditë. Komponenti jo-ushqimor i varfërisë u llogarit duke marrë në konsideratë përqindjen e shpenzimeve për artikujt jo-ushqimorë të atyre familjeve që shpenzonin për artikuj ushqimorë një vlerë të përafërt me kufirin e varfërisë për ushqim. I llogaritur në këtë mënyrë, kufiri i varfërisë për ushqim (ose kufiri i varfërisë së tejskajshme) u vendos në 3.047 Lekë për frymë në muaj ndërsa kufiri i plotë i varfërisë, i plotësuar me nevojat për artikujt bazë jo-ushqimorë, u vendos në 4.891 Lekë për frymë në muaj me çmime konstante (2002).

Varfëria Jo-monetare: Varfëria jo-monetare përbëhet nga tregues që nuk kanë lidhje me aspektin monetar por me aksesin në shërbimet bazë dhe cilësinë e tyre. Në aspektin jo-monetar merren tregues që lidhen me kushtet e jetesës, zotërimin e pajisjeve dhe aksesin në shërbimet bazë si: papërshtatshmëria e furnizimit me ujë dhe tualetit, papërshtatshmëria e kushteve të strehimit (sipas perceptimit të vetë familjes), papërshtatshmëria e nivelit arsimor të kryefamiljarit (me arsim primar ose më të ulët), moszotërimi i pajisjeve bazë të nevojshme, etj.

Përqindja e të varfërve (P0) mat përqindjen e popullsisë që është e varfër, pra popullsinë që ka të ardhurat ose konsumin poshtë kufirit të varfërisë. Problemi qëndron se ky indikator nuk tregon sa të varfër të varfërit janë.

$$P0 = N_p / N$$

N_p numri i të varfërve

N numri total i popullsisë

Hendeku i varfërisë (P1) mat masën e shtrirjes poshtë kufirit të varfërisë të secilit individ si pjesë e kufirit të varfërisë, pra sa larg janë të varfërit nga kufiri i varfërisë. Llogarit njëkohësisht të ardhurat ose konsumin mesatar poshtë kufirit të varfërisë ose llogarit burimet totale të nevojshme që duhen për të sjellë të varfërit në kufirin e varfërisë. Shuma e këtyre hendeqeve të varfërisë na jep koston minimale të eliminimit të varfërisë. Por ky indikator nuk na jep ndryshimet e pabarazisë midis të varfërve.

$$G_i = (z - y_i) \cdot I(y_i < z)$$

G_i hendeku i varfërisë

Z kufiri i varfërisë

Y_i të ardhurat e të varfërve

$$P1 = 1/N \sum (G_i / N)$$

Ashpërsia e varfërisë (P2) është mesatarja e katrorit të hendeqeve të varfërisë. Na jep jo thjesht distancën e të varfërve nga kufiri i varfërisë, por edhe pabarazinë ndërmjet të varfërve.

$$P2 = 1/N \sum (G_i / N)^2$$

PRODUKTI I BRENDSHËM BRUTO (PBB)

Gjetjet kryesore

Në vitin 2012 PBB me çmime korrente ishte 1.335,5 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej rreth 1,6 % krahasuar me vitin 2011.

Sipas qarqeve vlere më e ulët në PBB paraqitet në qarkun e Kukësit me 27,9 miliardë lekë ose 2,1 % ndaj totalit të PBB-së. Krahasuar me vitin 2011, PBB me çmime korrente për qarkun Kukës shënoi një rënie prej 4,3 %. Sipas qarqeve, pesha më e ulët ndaj totalit të PBB-së në rang vendi u shënuar në qarkun Kukës me 2,1 % dhe në qarkun Gjirokastrë me 2,2 %.

Ndërsa peshën më të madhe të PBB-së e shënoi qarku Tiranë me 38,2 % me një vlerë totale të PBB-së prej 510 miliardë lekë. Krahasuar me vitin 2011 PBB me çmime korrente në qarkun Tiranë shënoi një rritje prej 2,1 %.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur disa nga rezultatet më të rëndësishme të Llogarive Kombëtare Rajonale në Shqipëri.

Tab. 1 Treguesit kryesorë ekonomikë, viti 2012

Qarqet	PBB çmime korrente (milion lekë)	Struktura ndaj PBB-së (%)	PBB për frymë (në lekë)	Struktura e indeksit për frymë ndaj PBB-së (%)
Shqipëria	1.335.489	100	460.436	100
Berat	54.192	4,1	371.324	80,6
Dibër	43.236	3,2	309.670	67,3
Durrës	132.212	9,9	481.007	104,5
Elbasan	105.245	7,9	346.054	75,2
Fier	166.222	12,4	520.813	113,1
Gjirokastrë	29.093	2,2	392.225	85,2
Korçë	72.962	5,5	321.697	69,9
Kukës	27.898	2,1	319.935	69,5
Lezhë	45.349	3,4	327.027	71,0
Shkodër	71.805	5,4	323.480	70,3
Tiranë	510.093	38,2	649.737	141,1
Vlorë	77.182	5,8	422.054	91,7

*Vlerësimet për vitin 2012 bazohen në të dhëna gjysmë-finale

Rritja ekonomike e PBB-së

Produkti i Brendshëm Bruto në vitin 2012, shënoi një rritje ekonomike reale në krahasim me vitin 2011 me 1,6 %. PBB reale për vitin 2012 pati variacione në nivelet e rritjes sipas qarqeve. Niveli i rritjes në disa vite të veçanta dhe në disa qarqe të veçanta varet nga kontributi individual i secilit qark në totalin e PBB-së, nga struktura e degëve të ekonomisë, etj. Në tabelën numër 2 janë paraqitur ritmet e rritjes sipas qarqeve:

PBB për frymë

Në vitin 2012 niveli i PBB-së për frymë në rang vendi ishte rreth 460 mijë lekë. Krahasuar me vitin 2011 PBB për frymë u rrit me 2,7 %.

Niveli më i lartë i PBB-së për frymë sipas qarqeve në vitin 2012 ishte Tirana me rreth 650 mijë lekë ose 41,1 % mbi mesataren e vendit dhe pati një rritje prej 0,8 % krahasuar me 2011. Më pas renditet qarku i Durrësit me rreth 481 mijë lekë ose 4,5 % mbi mesataren e vendit, me një rritje prej 0,7 % krahasuar me 2011. Më pas renditet qarku i Fierit me rreth 521 mijë lekë ose 13,1 % mbi mesataren, me një rritje prej 16,1 % krahasuar me 2011.

PBB për frymë për qarqet e tjera ishte nën mesataren e vendit ku më e ulta ishte ajo e qarkut të Dibrës me rreth 310 mijë lekë ose 32,7 % nën mesataren e vendit. Më tej, me PBB-në për frymë më të ulët vijon qarku i Kukësit, me rreth 320 mijë lekë ose 30,5% nën mesataren e vendit. PBB-ja për frymë në qarkun Korçë, ishte rreth 322 mijë lekë, ose 30,1 % nën mesataren e vendit.

Tab. 2 Rritja Reale e PBB-së

Rritja reale e PBB-së				
Qarku=100	2009	2010	2011	2012
Republika e Shqipërisë	3,4	3,7	2,5	1,6
Berat	3,1	6,8	4,9	-2,1
Dibër	4,0	7,4	-2,3	13,2
Durrës	2,9	11,3	1,3	1,2
Elbasan	2,4	12,9	5,6	-0,8
Fier	1,6	6,7	3,3	8,6
Gjirokastrë	3,3	4,6	14,3	-11,3
Korçë	3,4	1,5	1,9	1,2
Kukës	4,3	3,8	4,5	-4,3
Lezhë	3,0	-1,8	1,6	9,6
Shkodër	4,3	6,8	-1,7	-2,7
Tiranë	3,9	0,5	1,5	2,1
Vlorë	3,2	-4,5	6,8	-5,5

Fig.1 PBB për frymë sipas qarqeve krahasuar me mesataren e vendit




Fig. 2 PBB sipas qarqeve






Fig. 3 PBB për frymë sipas qarqeve



Kufijtë e komunave dhe bashkië janë krijuar për qëllime statistikore dhe mund të mos përputhen plotësisht me territorin e njësië lokale.

Burimi: INSTAT, 2014

Tab. 3 Produkti i Brendshëm Bruto me çmime korrente

Në mln lekë

Qarqet	2008	2009	2010	2011	2012*
Shqipëria	1.080.676	1.143.937	1.239.645	1.300.624	1.335.489
Berat	42.694	45.187	50.769	54.592	54.192
Dibër	31.739	34.187	38.784	38.171	43.236
Durrës	103.018	109.722	126.245	129.921	132.212
Elbasan	79.339	84.708	99.805	105.856	105.245
Fier	110.129	111.906	130.871	144.648	166.222
Gjirokastrë	24.152	25.544	27.890	32.472	29.093
Korçë	60.795	64.981	68.993	71.794	72.962
Kukës	23.394	25.122	27.600	29.179	27.898
Lezhë	36.640	38.868	39.882	41.294	45.349
Shkodër	61.002	65.688	74.088	73.687	71.805
Tiranë	437.495	463.838	480.440	497.619	510.093
Vlorë	70.279	74.185	74.278	81.391	77.182

*Vlerësimet për vitin 2012 bazohen në të dhëna gjysmë-finale

Tab. 4 Produkti i Brendshëm Bruto për frymë në Lekë

Në lekë

Qarqet	2008	2009	2010	2011	2012*
Shqipëria	366.665	390.754	425.554	447.754	460.436
Berat	266.736	290.892	335.387	368.464	371.324
Dibër	204.248	227.262	265.396	267.885	309.670
Durrës	393.760	415.217	471.571	477.615	481.007
Elbasan	249.550	271.319	323.729	345.890	346.054
Fier	324.389	335.683	399.460	448.466	520.813
Gjirokastrë	275.667	303.871	347.230	424.125	392.225
Korçë	254.490	276.087	297.333	313.791	321.697
Kukës	246.346	271.812	305.599	329.255	319.935
Lezhë	254.351	274.083	284.376	296.302	327.027
Shkodër	260.872	284.891	325.888	328.928	323.480
Tiranë	604.972	627.582	636.036	644.342	649.737
Vlorë	369.347	393.356	398.808	442.650	422.054

*Vlerësimet për vitin 2012 bazohen në të dhëna gjysmë-finale

Tab. 5 Produkti i Brendshëm Bruto për frymë

Në përqindje

Qarqet	2008	2009	2010	2011	2012*
Shqipëria	100	100	100	100	100
Berat	72,7	74,4	78,8	82,3	80,6
Dibër	55,7	58,2	62,4	59,8	67,3
Durrës	107,4	106,3	110,8	106,7	104,5
Elbasan	68,1	69,4	76,1	77,3	75,2
Fier	88,5	85,9	93,9	100,2	113,1
Gjirokastrë	75,2	77,8	81,6	94,7	85,2
Korçë	69,4	70,7	69,9	70,1	69,9
Kukës	67,2	69,6	71,8	73,5	69,5
Lezhë	69,4	70,1	66,8	66,2	71
Shkodër	71,1	72,9	76,6	73,5	70,3
Tiranë	165	160,6	149,5	143,9	141,1
Vlorë	100,7	100,7	93,7	98,9	91,7

*) Vlerësimet për vitin 2012 bazohen në të dhëna gjysmë-finale

Tab. 6 Struktura e Vlerës së Shtuar Bruto (VSHB) sipas degëve të ekonomisë dhe qarqeve, viti 2012*

Në përqindje

Qarqet	Bujqësia dhe Peshkimi	Industria Nxjerrëse	Industria Përpunuese	Ndërtimi	Shërbimet	Tregti, Hotele dhe Restorante	Transporti	Posta dhe Telekomunikacioni	Shërbime të tjera	VSHB me çmime bazë
Shqipëria	100	100	100	100	100	100	100	100	100	100
Berat	7,9	3,1	2,2	3,7	3,5	2,8	2,5	2,4	3,4	4,1
Dibër	6,3	4,6	8,1	2,3	1,2	2,1	1,1	0,4	2,2	3,2
Durrës	7,6	10,6	2,3	16	6,4	11,5	11,4	38,6	5,7	9,9
Elbasan	12,3	7,7	2,3	11,2	5,3	6,6	8,5	4,1	4	7,8
Fier	19,9	28,7	61,1	7,9	5,8	6,3	6,5	4	4,8	12,4
Gjirokastrë	3,7	0,7	0,1	1,1	1,2	2,2	1	1,9	3	2,2
Korçë	9,7	4,1	0,6	6,3	4,5	4,3	3,3	1,2	4	5,5
Kukës	3,5	1,1	0,3	1,7	2,6	1,6	0,9	1,1	1,8	2,1
Lezhë	5,3	2,8	3,8	2,1	3	2,9	2,3	3,9	2,5	3,4
Shkodër	8,3	4,5	1,2	6,6	4,3	4,6	3	3	3,9	5,3
Tiranë	8,2	27,3	10,7	37,9	56	49,7	55	33,1	59,2	38,2
Vlorë	7,3	4,8	7,2	3,3	6,1	5,4	4,5	6,2	5,5	5,8

*) Vlerësimet për vitin 2012 bazohen në të dhëna gjysmë-finale

Tab. 7 Struktura e Vlerës së Shtuar Bruto (VSHB) sipas degëve të ekonomisë dhe qarqeve, viti 2012*

Në përqindje											
Qarqet	Bujqësia dhe Peshkimi	Industria Nxjerrëse	Industria Përpunuese	Ndërtimi	Shërbimet	Tregti, Hotele dhe Restorante	Transporti	Posta dhe Telekomunikacioni	Shërbime të tjera	VSHB me çmime bazë	
Shqipëria	21.8	14.4	5.6	8.8	12.2	51.6	15.1	3.8	3.0	29.7	100.0
Berat	42.7	11.0	3.0	8.0	10.5	35.9	9.3	2.3	2.5	21.7	100.0
Dibër	42.2	20.3	14.1	6.2	4.7	32.8	5.3	0.5	2.1	24.9	100.0
Durrës	16.6	15.5	1.3	14.2	7.9	60.0	17.4	14.8	1.7	26.0	100.0
Elbasan	34.1	14.2	1.6	12.6	8.2	43.5	16.3	2.0	1.5	23.6	100.0
Fier	34.9	33.2	27.7	5.6	5.6	26.2	8.0	1.2	1.2	15.9	100.0
Gjirokaštër	37.2	4.7	0.2	4.5	6.7	51.4	7.1	3.3	4.1	36.8	100.0
Korçë	38.7	10.8	0.6	10.1	10.1	40.4	9.1	0.8	2.2	28.3	100.0
Kukës	36.9	7.9	0.8	7.1	15.4	39.8	6.5	1.9	2.7	28.7	100.0
Lezhë	33.7	11.7	6.3	5.5	10.7	43.9	10.3	4.4	2.2	27.0	100.0
Shkodër	33.9	12.2	1.3	10.9	9.8	44.1	8.4	2.1	2.2	31.4	100.0
Tiranë	4.7	10.3	1.6	8.7	17.8	67.2	21.8	3.3	4.6	37.4	100.0
Vlorë	27.5	11.9	7.0	4.9	12.7	47.9	11.6	4.1	2.8	29.5	100.0

*) Vlerësimet për vitin 2012 bazohen në të dhëna gjysmë-finale

INSTAT kryen vlerësimin e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) sipas qarqeve duke u mbështetur kryesisht në metodën e prodhimit, e cila rezulton që të shprehë më mirë PBB sipas qarqeve bazuar në informacionin e disponueshëm. Llogaritjet e PBB-së përfshijnë të gjitha prodhimet e shërbimet aktuale të destinuara për treg si dhe ato të prodhuara për konsum vetjak nga të gjitha njësitet rezidente që veprojnë në territorin të cilësuar "ekonomik" të Shqipërisë. PBB me metodën e prodhimit shpreh shumën e vlerave të shtuara bruto sipas degëve të ekonomisë duke shtuar taksat e tatimit dhe duke zbritur subvencionet mbi produktet.

Konceptet dhe klasifikimet e përdorura

Llogaritë Rajonale në Republikën e Shqipërisë bazohen në të njëjtat koncepte të Sistemin Europian të Llogarive Kombëtare (ESA), versioni kombëtar i Nomenklaturave të Veprimtarive Ekonomike të miratuara nga nomenklatura ESA dhe e përdorur gjerësisht në Llogaritë Kombëtare.

Llogaritë Rajonale sigurojnë një ndarje rajonale për agregatet më të rëndësishëm si Vlera e Shtuar Bruto (VSHB), Produkti i Brendshëm Bruto, etj, sipas degëve kryesore të ekonomisë. Me vlerësimin e Llogarive Rajonale diferencat strukturore rajonale, zhvillimet e ekonomisë bëhen më të dukshme.

Parimi i Rezidencës

Parimi kryesor për alokimin e VSHB-së në Llogaritë Rajonale është se VSHB duhet të alokohet në rajonin ku njësia prodhuese është rezidente, pra që do të thotë se VSHB shpërndahet në rajonin ku krijohet.

Klasifikimi i njësive statistikore

Disa nga çështjet specifike të Llogarive Rajonale lidhen me klasifikimin e përshtatshëm të njësive sipas rajoneve. Në Llogaritë rajonale vetëm njësia (ndërmarrja) dhe vendndodhja e saj nuk mjafton, por kërkohet informacion tjetër më i detajuar si psh. njësitet e aktivitetit ekonomik lokal (Local KAU). KAU lokale është një njësi institucionale e ndodhur në një rajon. Kjo është e identifikuar me rajonin ku është dhe qendra e interesit: rajoni ku KAU lokale ndodhet fizikisht.

Trajtimi i njësive multi-rajonale

Mjaft njësi prodhuese kanë filiale në më shumë se një rajon dhe janë aktive në më shumë se një degë të ekonomisë. Dega ku kjo njësi do të klasifikohet duhet t'i korrespondojë njësive lokale. Trajtimi i njësive multi-rajonale dhe njësive që kanë disa aktivitete është i njëjtë me trajtimin që bëhet nga Llogaritë Kombëtare Vjetore. Analiza fillon me përcaktimin e aktivitetit kryesor që ushtron njësia aktivitetit dytësor dhe

aktivitetet ndihmëse. Aktiviteti kryesor i një njësie lokale (local KAU) është aktiviteti ku vlera e shtuar është më e lartë se në aktivitetet e tjera që ushtron njësia. Një aktivitet dytësor është aktiviteti i cili ndërmerret si aktivitet shtesë së bashku me aktivitetin kryesor.

Një vështrim i përgjithshëm i metodologjisë

Vlerësimet janë në përputhje me Sistemin Europian të Llogarive Kombëtare (ESA) të cilat konsistojnë në një kombinim të metodave kryesore sipas Manualit të ESA Kapitulli 13:

- Metoda Poshtë-Lart
- Metoda Lart-Poshtë
- Metoda Pseudo-Poshtë-Lart (Mikse)

Në vlerësimin e Llogarive Rajonale, Vlera e Shtuar Bruto Llogaritet me çmime të vitit të kaluar. Në Llogaritjen e Prodhimit të Brendshëm Bruto sipas rajoneve statistikore, VSHB kalohet me çmimet e tregut. Kjo arrihet me mbledhjen e taksave dhe zbritjen e subvencioneve sipas produkteve. Taksat dhe subvencionet janë shpërndarë sipas strukturës së VSHB-së. Në Llogaritjen e indikatorëve rajonalë me çmime të vitit të mëparshëm, janë përdorur deflatorët vjetorë sipas degëve të ekonomisë.

Burimet e informacionit

Për vlerësimin e PBB-së përdoret informacioni i siguruar nga burime të ndryshme statistikore dhe administrative. Të dhënat e përdorura mund të jenë prodhim statistikor i vetë INSTAT-it (anketa të ndryshme) ose i institucioneve të tjera kombëtare si Ministritë, Drejtoritë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Doganave, Qendra Kombëtare e Regjistrimit, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe të tjera.

Trajtimi i aktiviteteve ndihmëse

Njësia bazë e përpilimit të Llogarive rajonale është njësia lokale (Lokal KAU). Një njësi institucionale mund të përbëhet nga më shumë se një njësi lokale, e lokalizuar në më shumë se një rajon statistikor. Në momentin aktual nuk ka të dhëna sipas njësive lokale dhe degëve të ekonomisë për aktivitetet ndihmëse.

Krahasueshmëria në kohë

INSTAT publikon treguesit rajonalë në koherencë me zhvillimet dhe revizionimet e metodologjisë së Llogarive Kombëtare Vjetore. Rezultatet për çdo vit vlerësohen nga të dhëna të detajuara. Në rast se të dhënat mbi njësitet lokale mungojnë treguesit rajonalë vlerësohen duke marrë në konsideratë strukturën e vlerës së shtuar të një viti referencë.

REGJISTRAT E NJËSIVE EKONOMIKE

Hyrje

Regjistrat e njësive ekonomike përmbajnë të gjitha njësitë ligjore jo bujqësore (ndërmarrjet e institucionet) që ushtrojnë aktivitet ekonomik brenda territorit të Shqipërisë. INSTAT-i ka krijuar Regjistrin Administrativ të Ndërmarrjeve në vitin 1994 dhe që prej vitit 1998 mirëmban Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve. Regjistri i Njësive lokale u ndërtua në vitin 2010 si rezultat i kryerjes së Regjistrimit të Përgjithshëm të Njësive Ekonomike Jobujqësore.

Regjistrimi i Njësive Ekonomike Jobujqësore, nëntor 2010, i mbështetur nga Komisioni Europian, në kuadrin e Projektit IPA 2007 realizoi:

Përditësimin e Regjistrit Statistikor të Ndërmarrjeve sipas rekomandimeve dhe standardeve të BE-së, për prodhimin e statistikave ekonomike të besueshme, të sakta dhe sa më pranë përdoruesve duke bërë të mundur:

- Krijimin për herë të parë të Regjistrit të Njësive lokale, i cili do të shërbejë si bazë për llogaritjen e indikatorëve rajonal;
- Klasifikimin e dyfishtë të aktivitetit ekonomik sipas Nomenklaturës ekzistuese NVE Rev1.1 dhe Nomenklaturës së re NVE Rev.2.

Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve shërben për qëllime statistikore dhe identifikon qartësisht njësitë, në mënyrë që:

- të lejojë marrjen e informacionit për to nëpërmjet burimeve administrative;
 - të lejojë përgatitjen e kampionëve, koordinimin e anketave dhe grupimin e rezultateve të tyre;
 - të lejojë analizën demografike të popullsisë së ndërmarrjeve dhe njësive lidhur me to.
- Regjistri i Ndërmarrjeve është bazë për hartimin e statistikave të nevojshme për dhënien e treguesve afat-shkurtër dhe të zhvillimeve strukturore ekonomike.

Baza ligjore

- Ligji nr. 9180, datë 5.2.2004 "Për statistikën zyrtare", i ndryshuar;
- Rregullore e Këshillit EU (EEC) nr. 177/2008 datë 20 shkurt 2008 mbi krijimin e regjistrave të ndërmarrjeve për qëllime statistikore;
- Vendim i Kuvendit të Shqipërisë nr. 3/2013 datë 14/02/2013 "Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2012-2016";
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 320, datë 28.5.2014 për "Për miratimin e nomenklaturës së veprimtarive ekonomike të revizionuar (Rev.2)";
- Ligji nr. 8957 datë 17.10.2002 "Për ndërmarrjet e vogla e të mesme, SME" ndryshuar me Ligjin nr. 10042 datë 22.12.2008.

Variablat kryesore të Regjistrit Statistikor të Ndërmarrjeve:

Variablat e identifikimit (NIPT, Forma ligjore, Pronësia, Emri, Adresa, Komunikimi (Tel, Faks etj.)

Variablat shtresor (Aktiviteti ekonomik kryesor, Madhësia sipas të punësuarve, Vendndodhja gjeografike, Sektori institucional, statusi)

Variablat demografik (Data e krijimit, Data e mbarimit)

Variablat kryesore të Regjistrit të Njësive lokale grupohen në këto kategori:

Variablat e identifikimit (Numri i identifikimit, Emri tregtar, Adresa)

Variablat shtresor (Aktiviteti ekonomik kryesor, Madhësia sipas të punësuarve, Tipi i njësive lokale, statusi).

Gjetjet kryesore

- 112.537 ndërmarrje ushtrojnë aktivitet ekonomik gjatë vitit 2014 krahasuar me 103.083 ndërmarrje aktive gjatë vitit 2010, pra në vitin 2014 kemi 9.454 ndërmarrje aktive më shumë;
- 17.377 është numri i ndërmarrjeve të reja në vitin 2014. Numrin më të madh të ndërmarrjeve të reja ashtu edhe numrin e ndërmarrjeve aktive në total , prej 44 % të ndërmarrjeve, e ka qarku i Tiranës ndërsa numrin më të vogël, prej 0.9 % të ndërmarrjeve, e ka qarku i Kukësit;
- 28,4 % e ndërmarrjeve aktive në vitin 2014 menaxhohen nga femrat krahasuar me 26,4 % që menaxhoheshin nga femrat në vitin 2009;
- **Në vitin 2014 janë 5.245 ndërmarrje që kanë pronarë** apo bashkëpronarë të huaj krahasuar me 3.141 që kanë qenë në vitin 2010. Numrin më të madh të këtyre ndërmarrjeve e ka qarku i Tiranës me 71,4% dhe numrin më të vogël e ka qarku Dibër me 0,3 %;
- Tregtia zë peshën më të madhe përsa i përket aktivitetit ekonomik. Në qarkun e Tiranës janë përqëndruar më shumë ndërmarrjet tregtare, ku në 5 vitet e fundit kanë një peshë mesatare prej 39 %, ndërsa qarku i Kukësit ka peshën më të vogël, prej 0,9 %;
- Ndërmarrjet me 1 deri në 4 të punësuar numërojnë afërsisht 90 % të ndërmarrjeve gjithsej aktive, dhe qarku i Beratit dhe qarku i Korçës kanë përqindjen më të lartë në nivel qarku me afërsisht 93 %.

Burimi i të dhënave

Regjistrat e njësive ekonomike bazohen në burime administrative nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si dhe duke filluar nga viti 2007 nga Qendra Kombëtare e Regjistrimeve, një reformë e rëndësishme kjo për thjeshtësimin e regjistrimit dhe procedurën e regjistrimit të ndërmarrjeve.

Burime administrative:

- Informacioni nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;
- Informacioni nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- Skedari i TVSH-së;
- Llogaritë vjetore të ndërmarrjeve.

Burime statistikore(vrojtimet pranë ndërmarrjeve):

- Anketa e Ndërmarrjeve të Reja;
- Anketa e Njësive Lokale;
- Anketa Strukturore pranë Ndërmarrjeve;
- Anketa Tremujore pranë Ndërmarrjeve;
- Anketa e Çmimeve të Prodhimit, IÇP;
- Anketa të tjera;

Përkufizime

Njësia ligjore

Njësia ligjore nuk është direkt njësi statistikore. Njësia ligjore mund të jetë:

- Person juridik, ekzistenca e të cilit njihet nga ligji. pavarësisht nga individët apo institucionet që mund ta zotërojnë apo janë anëtarë në të;
- Person fizik i angazhuar në një aktivitet ekonomik në të drejtën e tij.

Ndërmarrja

- Ndërmarrja është: "kombinimi më i vogël i njësive ligjore pra një njësi organizative që prodhon të mira apo shërbime që ka një farë autonomie në marrjen e vendimeve, veçanërisht për shpërndarjen e burimeve aktuale të saj. Ndërmarrja kryen një ose me shumë aktivitete në një apo më shumë vendndodhje (njësi lokale)".
- Marrëdhënia mes një ndërmarrjeje dhe një njësie ligjore përkufizohet si: "ndërmarrja i korrespondon ose një njësie ligjore ose një kombinimi njësisht ligjore".

Njësia lokale


Njësia lokale është një ndërmarrje apo pjesë e saj (p.sh. manufakturë, fabrikë, magazinë, zyrë, minierë apo depo) të ndodhura në zona të identifikuara gjeografikisht. Tek ky apo nga ky vend ushtrohet aktiviteti ekonomik për të cilin – me përjashtim të disa rasteve – punojnë një ose më shumë persona (edhe pse me kohë të reduktuar) për një ndërmarrje të vetme.

Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike (NVE), është klasifikim në nivel katërshifror i veprimtarive ekonomike të ushtruara në subjekte të ndryshme. Kjo nomenklaturë është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, nr. 320, datë 28.5.2014.

Shkalla e lindshmërisë

Shkalla e lindshmërisë së ndërmarrjeve në një periudhë të caktuar është numri i ndërmarrjeve të reja si përqindje ndaj totalit të ndërmarrjeve aktive.

Fig. 1 Shpërndarja e ndërmarrjeve aktive sipas qarqeve



Tab. 1 Ndërmarrje aktive, krijuar të reja dhe shkalla e lindshmërisë

	2010	2011	2012	2013	2014
Ndërmarrje aktive	103.038	109.039	106.837	111.083	112.537
Krijuar të reja	16.469	12.905	12.828	12.131	17.377
Shkalla e lindshmërisë	16	12	12	11	15
Njësitë lokale aktive	109.252	118.657	118.578	123.332	*
Ndërmarrje aktive me pronare / administratore femër, %	26	27	27	28	28

* Të dhënat ende nuk janë të disponueshme

Tab. 2 Ndërmarrjet aktive sipas qarqeve

viti 2010-2014

Qarqet	2010		2011		2012		2013		2014	
	Nd.aktive	Pronare / administratore femër	Nd.aktive	Pronare / administratore femër	Nd.aktive	Pronare / administratore femër	Nd.aktive	Pronare / administratore femër	Nd.aktive	Pronare / administratore femër
Shqipëria	103.038	27.272	109.039	29.381	106.837	29.284	111.083	30.827	112.537	32.023
Berat	4.366	1.140	4.545	1.225	4.470	1.247	4.557	1.270	4.302	1.229
Dibër	2.097	354	2.142	375	1.945	341	2.077	376	2.164	404
Durrës	12.316	3.153	12.918	3.377	11.625	3.121	10.599	2.816	9.578	2.640
Elbasan	6.972	1.694	7.611	1.900	7.311	1.820	7.442	1.858	7.859	2.016
Fier	9.416	2.348	9.924	2.543	9.527	2.527	9.830	2.615	9.693	2.576
Gjirokastër	2.926	641	3.022	694	2.642	613	2.814	655	2.681	644
Korçë	6.673	1.670	6.843	1.748	6.610	1.667	6.728	1.742	7.311	1.965
Kukës	998	128	1.053	139	986	140	1.062	160	1.068	167
Lezhë	2.844	668	3.104	743	2.954	731	3.189	796	3.388	970
Shkodër	6.258	1.479	6.607	1.592	6.543	1.644	5.945	1.565	5.446	1.508
Tiranë	39.656	11.838	42.117	12.642	43.295	13.055	47.477	14.455	49.467	15.197
Vlorë	8.516	2.159	9.153	2.403	8.929	2.378	9.363	2.519	9.580	2.707

